

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA



RREGULLORJA E GARAVE

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME | 2 |
| II. SISTEMI I GARAVE TË PËRHERSHME | 3 |
| II/1. Garat e përhershme | 4 |
| II/2. Kushtet për organizimin e garave | 5 |
| II/3. Pjesëmarrja në garat e përhershme | 5 |
| III. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR GARA | 5 |
| III/1. Viti garues | 5 |
| III/2. Kalendar i garave | 5 |
| III/3. Orari i ndeshjeve të garave të përhershme | 6 |
| III/4. Ndryshimi i orarit të zhvillimit të ndeshjeve | 6 |
| III/5. Shtyrja e ndeshjës | 6 |
| III/6. Koha e fillimit të ndeshjeve të garave të përhershme | 7 |
| III/7. Gjyqtarët | 9 |
| III/8. Trajnerët | 11 |
| III/9. Përfaqësuesi i klubit dhe personi përgjegjës për siguri | 12 |
| PROTOKOLI I NDESHJËS (Procesverbali i ndeshjës) | 13 |
| LOJTARËT..... | 17 |
| FANELAT..... | 18 |
| ORGANIZIMI I NDESHJËS | 19 |
| Sistemi i KUPËS | 33 |
| IV. DISPOZITAT E POSAÇME | 42 |
| DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT | 43 |

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës miratoi plotësimet dhe ndryshimet e Rregullores së Garave të Lojës së Futbollit paraprake, bazuar në Nenin 2, pika c), g) dhe m), Nenin 41, pika c) dhe n), Nenin 49, Nenin 77 dhe Nenin 81 të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës, të miratuar më 27.01.2023, dhe në mbledhjen e vet të mbajtur më 04 korrik 2023, aprovon:

RREGULLORE E GARAVE TË LOJËS SË FUTBOLLIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Rregullorja e garave të futbollit përmban dispozitat themelore mbi sistemin e garave të përhershme dhe kushtet e përgjithshme të garave.

Me gara të përhershme në kuptim të kësaj Rregulloreje konsideron garat kampionale dhe të KUPËS, të cilat zhvillohen çdo vit garues.

Neni 2

Të gjitha ndeshjet publike të futbollit në Kosovë që i organizon FFK-ja, me organet, organizatat dhe anëtarët e saj zhvillohen sipas rregullave të lojës së futbollit të cilat i nxjerr Bordi ndërkombëtar, ndërsa i shpall Organizata Ndërkombëtare e Futbollit (FIFA).

Ndeshjet e futbollit të femrave zhvillohen gjithashtu sipas rregullave të cilat gjithashtu i nxjerr Bordi ndërkombëtar.

Ndeshjet në futboll të vogël zhvillohen sipas Rregullave të posaçme të lojës për Futsall, të cilat i nxjerr Bordi ndërkombëtar.

Vendimet për zbatimin e Rregullave të lojës së futbollit të Bordit Ndërkombëtar në kuadër të autorizimeve të veta i bien Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, ndërsa udhëzimet më të afërta për zbatimin e këtyre vendimeve i japin organet gjegjëse të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, (në tekstin e mëtutjeshëm: Komiteti Ekzekutiv-KE).

Tekstin zyrtar të Rregullave të lojës me vendimet e FFK-së për zbatimin e rregullave të lojës dhe udhëzimeve i shpallë FFK-ja.

II. SISTEMI I GARAVE TË PËRHERSHME

Neni 3

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së e përcakton sistemin unik të garave të futbollit në nivel të Kosovës dhe nxjerrë dispozitat e përgjithshme të garave të përherëshme për tërë territorin e Kosovës.

Neni 4

Vendimet e sistemit të garave përmbajnë:

- mënyrën e garimit: sistemin e pikëve apo sistemi i kupës,
- rangun i garave,
- ligat garuese, grupet në kuadër të rangut të njëjtë,
- numri i klubeve (ekipeve garuese) në rangun e njëjtë,
- mënyra e marrjes së drejtës në gara e rangut përkatës,
- kushtet të cilat duhet përmbushur klubet (ekipet garuese) në rangjet e caktuara të garave.

Neni 5

Sistemin e përherëshëm të garave në disa rangje në Kosovës (Superliga, Liga e I-rë, II-të), e cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, i cili duhet të jetë në përputhje me sistemin unik dhe dispozitat e përgjithshme. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së i cakton organet dhe komisionet të cilat udhëheqin edhe mbikëqyrin këto gara.

Neni 6

Vendimi për ndryshimin e sistemit të garave nxjerrët (bëhet) më së voni një vit para fillimit të garave.

Propozimin për ndryshimin e sistemit të garave mund ta bënë KE, Lidhja Rajonale e futbollit, organizatat profesionale (e Referëve, trajnerëve etj.) dhe shoqatat e klubeve të futbollit, ndërsa Vendimin e merr KE i FFK-së.

Neni 7

Garat mund të organizohen sipas sistemit të njëfishtë, dyfishtë, trefishtë, katërfishtë dhe të KUPËS ose sistemit të kombinuar, pastaj sipas sistemit të pikëve dhe sistemit të KUPËS, e në raste të posaçme, në sistem të turneut.

Në rast të situatave të paparashikuara (fuqia madhore dhe te tjera), KE ka të drejtën ekskluzive që të vendos në mënyrë meritore për formën e sistemit të garave.

Neni 8

Mënyrën e udhëheqjes së garave të Superligës, Ligës së I-rë, të II-të, Juniorëve dhe Ligës nacionale për kadetë e përcakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Lidhjet rajonale të futbollit organizojnë ligat rajonale për kategori: U-9, U-11, U-13, U-15 dhe U-17, por gjithsesi sipas autorizimeve të KE-së dhe në bazë të akteve të saja normative (Propozicionet e garave për grup moshë të reja).

Neni 9

Propozicionet e garave janë specifike, për garat në Superligë, Liga e I-rë, II-të, kategoritë e U-19, Ligës së U-17, futbollit të femrave dhe futbollit kanë propozicione të veçanta, si dhe kategorive të reja që garojnë në kuadër të Lidhjeve Rajonale të Kosovës. Këto akte i miraton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Me Propozicione më për së afërmi përcaktohen rregullat për zhvillimin e garave, përcaktohen dhe vërtetohen kushtet nën të cilat zhvillohen garat, pastaj theksohen organet të cilat udhëheqin me gara si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe çështje të tjera që parashihen me këtë Rregullore.

Propozicionet nuk mund të jenë në kundërshtim me këtë Rregullore si dhe aktet tjera të përgjithshme të FFK-së. Në rast të kundërshtimit të dispozitave të Propozicioneve me Rregulloren e Garave, aplikohen dispozitat e Rregullores së Garave.

II/1. Garat e përhershme

Neni 10

Gara të përhershme në territorin e Kosovës janë:

- Kampionatet e futbollit të Kosovës,
- Kupa e Kosovës në futboll,
- Kampionati i Kosovës për U-19,
- Kampionati i Kosovës për U-17,
- Kampionati i Kosovës në Futsall,
- Kampionati i Kosovës në futboll të Femrave,
- Kampionati i Kosovës në futbollin e femrave U-16,
- Kampionati për grup moshat e reja (U-15, U-13 dhe U-11).

Në të ardhmen do të zhvillohet edhe kupa e Kosovës kampionati për kategoritë e reja. Gara të përhershme konsiderohen edhe kualifikimet për hyrje në rang më të lartë, nëse ato parashihen me sistem të caktuar të garave.

Lidhjet rajonale, përmes Komisionit Organizativ të Garave të grupeve përkatëse organizojnë dhe zbatojnë në territoret e tyre garat e përhershme të klubeve nga paragrafi 1, e këtij neni (ligat rajonale dhe garat e kategorive të reja), si dhe marrin vendime lidhur me organizimin e garave kampionale që janë në kompetencë të saj.

II/2. Kushtet për organizimin e garave

Neni 11

Garat kampionale sipas rregullit, organizohen në formë të Ligës sipas sistemit të dyfishtë, trefishtë apo katërfishtë.

Në gara marrin pjesë vetëm ekipet e licencuara nga KE i FFK-së, (Komisioni për licencimin e klubeve dhe lojtarëve).

Numri i ekipeve në ligë dhe grupe përcaktohet me vendimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, në përputhshmëri të sistemit të garave.

II/3. Pjesëmarrja në garat e përhershme

Neni 12

Klubet e Superligës, Ligës së parë, të dytë dhe të tretë të Kosovës mund të marrin pjesë në të gjitha garat e përhershme me grup mosha të reja (U-19, U-17, U-15, U-13 dhe U-11).

Në Lidhjet Rajonale marrin pjesë edhe akademitë dhe shkollat e futbollit me të gjitha grup moshat.

III. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR GARA

III/1. Viti garues

Neni 13

Viti garues fillon me 1 korrik, ndërsa përfundon më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Viti është i ndarë në dy stinor: Stinorin vjeshtor dhe pranveror.

III/2. Kalendari i garave

Neni 14

Me kalendarin e garave përcaktohen orari për zhvillimin e ndeshjeve të garave të përhershme, ndeshjeve tjera zyrtare dhe të turneve. Kalendarin përgatitet posaçërisht për çdo vit garues, dhe atë më së voni 15 ditë para fillimit të stinorit vjeshtor.

Kalendarin e rangut më të ulët të garave duhet të jetë në përputhje (pajtim) me kalendarin e garave të rangut më të lartë. Kalendarin e garave e propozon Komisioni respektiv i garave, ndërsa e miraton Komiteti Ekzekutiv.

Neni 15

Orarin i përcaktuar me kalendarin e garave nuk mund të ndryshohet pa miratimin e Komisionit Organizativ të Garave, në bazë të kërkesës së kompanisë fituese për transmetim televiziv apo në raste urgjente nga KE i FFK-së.

Përfundimisht, për shkak të fuqisë madhore (Vis mayor) dhe rasteve të tjera të paparashikuara, organi i cili udhëheq me gara mund të ndryshojë terminin e xhiros së caktuar (apo të më shumë xhirove), me atë që për atë xhiro (apo ato xhirove) të caktojë termine të tilla, që nuk e çrregullojnë në masë të madhe kalendarin e garave.

III/3. Orari i ndeshjeve të garave të përhershme

Neni 16

Orarin e ndeshjeve të përhershme e përcakton organi i cili udhëheq me gara.

Orari i ndeshjeve caktohet me tërheqje të shortit. Në short hyjnë vetëm klubet e licencuara për atë vit garues dhe për atë kategori garuese. Tërheqja e shortit duhet bërë më së voni 15 ditë para fillimit të garave.

Me Propozicione të garave më për së afërmi përcaktohet afati dhe mënyra e komunikimit të vendimeve lidhur me orarin e zhvillimit të ndeshjës, terreni, fillimi i ndeshjës, personat zyrtarë etj.

III/4. Ndryshimi i orarit të zhvillimit të ndeshjeve

Neni 17

Orarin e përcaktuar dhe verifikuar të ndeshjeve kampionale dhe për KUPË, mund t'i ndryshojë organi i cili udhëheq me gara vetëm në bazë të kriteriumeve të përcaktuara më detajisht me Propozicione të garave gjegjëse, me atë që shtyrja, ndryshimi i terminit të ndeshjës apo xhiros së caktuar të garave, nuk mund të shkojë në dëm të ekipeve të interesuara, e as që mund t'ju jap përparësi ekipeve ndeshja e të cilave shtyhet në raport me pjesëmarrësit e grupit të njëjtë garues.

III/5. Shtyrja e ndeshjes

Neni 18

Nëse ekipi i jep dy ose më tepër lojtarë për Përfaqësuesen e Kosovës (kombëtaren), për të zhvilluar ndeshjen e paraparë me kalendarë të garave, atëherë kërkesa e tij mund të ndryshojë orarin e zhvillimit të ndeshjes kampionale apo për kupë.

Ndeshja mund të shtyhet për shkak të pjesëmarrjes së klubeve në garat ndërkombëtare, dhe për shkaqe të sigurisë. Ndeshjet e shtyra do të luhen menjëherë në terminin e parë të lirë, dhe këtë vendim e merr organi kompetent i garave (Komisioni Organizativ i garave).

Organi që udhëheq me gara, mund të marrë vendim mbi shtyrjen e ndeshjes konform dispozitave të paragrafi paraprak dhe ka për obligim t'i njoftojë me shkrim apo me e-mailin zyrtar të ekipet e interesuara, dhe atë më së voni tri ditë para terminit të përcaktuar me orar për fillimin e ndeshjes (termini i të cilës ndryshohet).

Neni 19

Nëse me vendimin e organit kompetent shtetëror për shkak të ditë-zisë ndalohet zhvillimi i aktiviteteve sportive ose ndeshja nuk mund të zhvillohet ditën e caktuar për shkak të fuqisë madhore (tërmeti, zjarrit, vërshimet etj.), atëherë të gjitha ndeshjet që është dashur të zhvillohen atë ditë shtyhen menjëherë (automatikisht).

Ndeshja e shtyrë do të zhvillohet të nesërmen në kohë të njëjtë nëse ka pushuar arsyeja e shtyrjes. Nëse ndeshja e shtyrë nuk mund të zhvillohet të nesërmen atëherë organi garues do të caktojë terminin e ri për zhvillimin e saj, duke pasur kujdes që termini i ri nuk shkon në dëm të ekipeve të interesuara.

Para fillimit të ndeshjeve të cilat luhen pas kalimit të ditës (ditë-zie), shprehen ngushëllimet me një minutë heshtje në mënyrë të paraparë me rregullat e lojës së futbollit.

III/6. Koha e fillimit të ndeshjeve të garave të përhershme

Neni 20

Koha e fillimit të ndeshjeve të garave të përhershme, caktohet nga ana e organit i cili udhëheq me gara duke pasur kujdes për rrethanat kohore, lokale dhe mediave, nëse ka interes për një gjë të tillë. Në raste të veçanta, klubet kanë të drejtë të propozojnë terminin por për këtë vendos organi që udhëheq me garat.

Kur ekziston marrëveshja ndërmjet ekipeve për kohën e fillimit të ndeshjes së garave të përhershme, organi kompetent sipas rregullit mund të aprovon këtë marrëveshje nëse nuk shkon në dëm të ekipeve tjera dhe në dëm të interesit të organizatës futbollistike.

Me Propozicionet e garave mund të parashihet që ndeshjet e xhirove të caktuara të rangjeve të caktuara garuese apo të grupeve të rangut të njëjtë të zhvillohen në ditën dhe kohën e njëjtë. Kohëzgjatja e ndeshjeve të futbollit përcaktohet sipas grup moshës dhe gjinisë.

Kohëzgjatjet e ndeshjeve sipas grup moshave;

| Ndeshje kampionale | | | | Ndeshje për Kupë | | | |
|--------------------|------------------|-------------|-----------|------------------|------------------|-------------|-----------|
| Nr | Kategoria | Kohëzgjatja | Vazhdimet | Nr | Kategoria | Kohëzgjatja | Vazhdimet |
| 1 | Seniorët | 2 x 45 | 2 x 15 | 1 | Seniorët | 2 x 45 | 2 x 15 |
| 2 | Juniorët | 2 x 45 | 2 x 15 | 2 | Juniorët | 2 x 45 | 2 x 15 |
| 3 | Kadetët | 2 x 45 | 2 x 15 | 3 | Kadetët | 2 x 45 | 2 x 15 |
| 4 | Pionierët | 2 x 35 | 2 x 05 | 4 | Pionierët | 2 x 35 | 2 x 05 |
| 5 | Pionierët e rinj | 2 x 30 | 2 x 05 | 5 | Pionierët e rinj | 2 x 30 | 2 x 05 |
| 6 | Fillestarët | 2 x 25 | 2 x 05 | 6 | Fillestarët | 2 x 25 | 2 x 05 |
| 7 | Para fillestarët | 2 x 20 | 2 x 05 | 7 | Para fillestarët | 2 x 20 | 2 x 05 |
| 8 | Femrat Seniorët | 2 x 45 | 2 x 15 | 8 | Femrat Seniorët | 2 x 45 | 2 x 15 |
| 9 | F. Kadetët | 2 x 35 | 2 x 10 | 9 | F. Kadetët | 2 x 35 | 2 x 10 |
| 10 | Futsall | 2 x 20 | 2 x 05 | 10 | Futsall | 2 x 20 | 2 x 05 |
| 11 | Futsall-Juniorët | 2 x 18 | 2 x 05 | 11 | Futsall-Juniorët | 2 x 18 | 2 x 05 |
| 12 | Futsall-Kadetët | 2 x 15 | 2 x 05 | 12 | Futsall-Kadetët | 2 x 15 | 2 x 05 |
| 13 | Futbolli në rërë | 3 x 12 | 1 x 03 | 13 | Futbolli në rërë | 3 x 12 | 1 x 03 |

Neni 21

Delegati Ndeshjës

Për të gjitha ndeshjet e garave të përhershme organi i cili udhëheqë me gara, e cakton delegatin. Në rast se në ndeshje nuk vjen delegati, atëherë detyrën e delegatit do ta ushtron gjyqtari kryesor nëse me propozicione të garave nuk parashihet ndryshe.

Të drejtat dhe detyrat e delegatit janë:

- që në praninë e përfaqësuesve të klubeve të vërteton identitetin e lojtarëve,
- të vërteton se trajnerët e kanë lejen gjegjëse për punë,
- konstaton rregullsinë e librezave të futbollit dhe të drejtën për lojë të lojtarëve të paraqitur dhe ua tërheqë vërejtjen përfaqësueseve të klubeve për mungesat dhe lëshimet e vërejtura,
- të vërtetojë praninë e gjyqtarëve të deleguar, mjekëve dhe të personave të tjerë zyrtarë që parashihen me akte të përgjithshme normative,
- të bëjë vlerësimin e gjykimit (nëse nuk është paraparë vëzhguesi i referimit), sipas dispozitave të udhëzimeve përkatëse të FFK-së. Nëse ndonjëri gjyqtar, vlerësohet me notë negative e **paraparë me Rregulloren e vlerësimit nga KGJF** ndaj tij do të iniciohet procedura disiplinore,
- që pas përfundimit të ndeshjes i kërkohet deklaratë lojtarit të përjashtuar dhe të merr deklaratat nga gjyqtarët dhe personat tjerë eventual lidhur me përjashtimin dhe ato t'ia bashkëngjisë protokollit. Në mënyrë të njëjtë të veprojë nëse janë larguar ose paraqitur trajnerët ose personat tjerë zyrtarë të klubeve,
- që të gjitha vrojtimit dhe vlerësimet e veta për dhe lidhur me ndeshje t'i cekë në protokollin e Ndeshjes respektivisht në raportin plotësues të cilin së bashku me protokoll dhe shkresa tjera ia dorëzon në afatin e paraparë organit kompetent, aty ku është e obligueshme delegatët e ndeshjeve raportet e tyre i bëjnë në bazë të platformës digjitale FIFA Konekt,
- krahas protokollit dhe raporteve përcjellëse, delegati obligohet të përpilojë edhe raportin e Fair Play-it të cilin ia dërgon Komisionit Organizativ të Garave (përmes formularit vlerësues),
- me Propozicione mund të rregullohen më detajisht kompetencat e delegatit lidhur me vlerësimet që ai mund t'i bëjë gjatë, lidhur me ndeshjen,
- Kryetari i Komitetit Ekzekutiv në bazë të autorizimit të Komitetit për ndeshjet e rëndësishme së posaçme mund të caktojë super-delegatin, i cili përpilon raport të shkruar, vlerëson gjykimin e gjyqtarëve etj. Raporti i tij mund t'iu shërbejë organeve kompetente për marrjen e vendimeve rreth çështjeve kontestuese nga ndeshja në të cilën kishte bërë super-vëzhgimin.

III/7. Gjyqtarët

Neni 22

Të gjitha ndeshjet e garave të përhershme dhe ndeshjet publike të klubeve si dhe ndeshjet e seleksioneve të ndryshme të përbëra nga lojtarët e klubeve të ndryshme, mund t'i drejtojnë vetëm gjyqtari aktiv i futbollit, anëtarë i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës.

Gjyqtari i futbollit nuk mund të paraqitet si lojtarë për klubin i cili garon në ligën në të cilën gjykon (referon) ai.

Gjyqtarët të cilët janë lojtarë aktiv në kohën e dënimit me ndalim të gjykimit (referimit) nuk mund të paraqiten në ndeshjet publike si lojtar, gjegjësisht në kohën e dënimit me ndalesë së ndeshjeve si lojtarë, nuk mund të referojë në ndeshjet publike.

Gjyqtarët e dënuar nga **organet e FFK-së**, në çfarëdo baze nuk mund të gjykojnë dhe të kryen funksion në asnjë garë të organizuar nga FFK-ja.

Të drejtat dhe obligimet e gjyqtarëve përcaktohen me Rregulloret e lojës së futbollit dhe ato të gjyqtarëve dhe gjykimit.

Neni 23

Nëse gjyqtari i caktuar nuk vjen në ndeshje të garës së përhershme, atë ndeshje do ta drejtojë gjyqtari i katërt apo gjyqtari i parë ndihmës, po që se nuk ka ardhur as gjyqtari i parë ndihmës, ndeshjën do ta drejtojë gjyqtari i dytë ndihmës.

Nëse në ndeshje nuk vjen gjyqtari kryesor e as gjyqtarët e caktuar ndihmës, klubet do të merren vesh ndërmjet veti që ndeshjën ta drejtojë ndonjëri prej gjyqtarëve të pranishëm (por ai duhet të jetë nga lista e gjyqtarëve të rangut përkatës).

Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet, atëherë delegati do të vendosë se cili prej gjyqtarit të pranishëm do ta drejtojë ndeshjën.

Marrëveshja mbi zgjedhjen e gjyqtarit duhet të vërtetohet me shkrim para fillimit të ndeshjës.

Procesverbalin mbi marrëveshjen e nënshkruajnë përfaqësuesit e klubeve dhe delegati.

Ky procesverbal i bashkëngjitet protokolit të ndeshjës.

Nëse nuk përpilohet procesverbali për këtë çështje, atëherë delegati do të kërkojë prej përfaqësuesve të klubeve, që të vërtetojnë në protokol marrëveshjen e arritur lidhur me gjyqtarin.

Nëse klubet nuk kanë arritur marrëveshjen për zgjedhjen e gjyqtarit nëse delegati e ka caktuar vetë kjo rrethanë duhet të konstatohet në protokolin e ndeshjës.

Kur në ndeshje nuk vjen gjyqtari kryesor, gjyqtarët ndihmës, e as delegati i ndeshjës, atëherë zhvillohet një ndeshje miqësore, nëse me propozicionet e garave nuk parashihet ndryshe.

Nëse në ndeshje vjen gjyqtari kryesor por nuk vjen njeri prej gjyqtarëve ndihmës apo të dy gjyqtarët ndihmës, atëherë do të veprohet në mënyrë analoge si në situatën e paraparë me dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni.

Nëse gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjës gjyqtarit kryesor i keqësohet gjendja shëndetësore ose paraqiten shkaqe të tjera për të cilat nuk mund të vazhdoj drejtimin e ndeshjës, detyrën e tij merr gjyqtari i katërt apo gjyqtari i parë ndihmës, ndërsa

detyrën e gjyqtarit ndihmës e merr njëri prej gjyqtarëve të pranishëm të cilin e cakton ai. Nëse e njëjta gjë i ndodh gjyqtarit ndihmës, atëherë do të veprohet sipas dispozitave të al.7 të këtij neni.

Në garat në të cilat për ndeshje caktohen katër gjyqtarë, obligimet e tyre si dhe procedura në rast të mosardhjes së ndonjërit gjyqtarë në ndeshje më për së afërmi rregullohen me propozicione të garave gjegjëse.

Prej momentit të delegimit gjyqtarët nuk kanë të drejtë të komunikojnë me zyrtarët e klubeve. Çdo komunikim i gjyqtarëve me zyrtarët e klubeve do të konsiderohet tendencë për marrëveshje apo mito dhe për këtë do të iniciohet procedurë disiplinore ndaj personave që kanë komunikuar. Përgjashtim bënë komunikimi me personin e autorizuar të klubit gjatë zhvillimit të ndeshjes e që ka të bëjë me organizimin e ndeshjes.

Gjyqtarët janë të obliguar të paraqesin çdo zyrtar të klubeve apo persona të tjerë të cilët i kanë kontaktuar apo kanë orvatur të kontaktojnë pas delegimit për ndeshje. Në të kundërtën do të kenë pasoja të parapara me Rregulloren Disiplinore.

Gjyqtarët në kuadër të FFK-së, vendimet e tyre duhet të i bazojnë në pamjet e sistemit VAR (Video Asistent Referee), dhe në video incizimet e televizioneve që transmetojnë ndeshjet. Gjyqtarët në Superligë duhet t'i zbatojnë parimet, praktikat dhe procedurat e protokollit të VAR-it (siç përcaktohet në Manualin e VAR-it

III/8. Trajnerët

Neni 24

Trajneri mund të kryejë detyrën e vet në ndeshje publike vetëm nëse posedon leje për punën në klubin e caktuar, përkatësisht licencën e lëshuar nga organi kompetent i FFK-së, në pajtim me dispozitat e akteve gjegjëse normative.

Ekipet e Superligës; kryetrajneri duhet të jetë i pajisur me Licencë; Profi dhe A-UEFA. Liga e Parë; minimum licenca; B, kurse Liga e dytë dhe tretë, juniorët dhe grup moshat e reja minimum licenca C.

Nëse ai nuk posedon licencën, delegati nuk do t'i lejon hyrjen atij, respektivisht qëndrimin në pjesën e rrethuar (pjesën restriktive) të stadiumit të paraparë për lojtarë rezervë dhe persona zyrtarë. **Në rast të largimit të kryetrajneri nga ana e klubit në Superligë dhe Ligën e parë, vendet e tyre në udhëheqjen e ekipeve në ndeshje zyrtare lejohen nga trajnerët me kategori jo adekuate vetëm për 2 (dy) xhiro të zhvilluara në vijim.**

Neni 25

Trajnerët të cilët marrin paga nuk mund të paraqiten në ndeshjet publike si lojtarë. Kjo vlen për Superligë dhe Ligën e Parë. Me këtë nocion nënkuptohen personat të

cilët paguhen për punën e tyre dhe janë të evidentuar në FFK si trajner i ekipit gjegjës. Kundër klubeve që nuk i përmbahen këtij kriteri, do të hapet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së.

III/9. Përfaqësuesi i klubit dhe personi përgjegjës për siguri

Neni 26

Secili klub duhet ta caktojë personin i cili do ta përfaqësojë klubin në ndeshje dhe personin përgjegjës për siguri. Në ndeshjet e garave të përhershme përfaqësuesi i klubit duhet të disponoj me autorizim me shkrim të klubit të vetë.

Përfaqësuesi i klubit në ndeshjet e garave të përhershme, përveç tjerave ka edhe këto të drejta dhe detyra:

- që t'i paraqitet delegatit dhe gjyqtarit më së voni 60 min. para fillimit të ndeshjës, nëse me propozicionet e garave nuk parashihet ndryshe,
- që menjëherë pas paraqitjes së delegatit t'ia dorëzojë (kumtojnë) formacionin e ekipit dhe dorëzojnë librezat e lojtarëve të cilët do të zhvillojnë ndeshjën dhe të atyre rezervë,
- të marrë pjesë në vërtetimin e identitetit të lojtarëve dhe të verifikojë rregullsinë e librezave futbolistike dhe duhet të ketë kartën e identifikimit nga klubi (bexhi),
- që para fillimit të ndeshjës ta vërtetojë formacionin e ekipit të vet, ndërsa pas përfundimit të ndeshjës të merre pjesë në përpilimin e protokolit dhe të paraqes vërejtjet eventuale të parapara me Propozicionet e garave,
- përfaqësuesi i klubit vendas është i obliguar që gjatë kohës sa zgjatë ndeshja të jetë në afërsi të delegatit, në mënyrë që t'i ofrojë ndihmë në eliminimin e dobësive eventuale të cilat paraqesin pengesa për zhvillimin normal të ndeshjës dhe të kryej punë të tjera që parashihen me akte të përgjithshme dhe Propozicione të garave.

Përgjegjësi për siguri i klubit, në ndeshjet e garave të përhershme, përveç tjerave ka edhe këto të drejta dhe detyra:

- që te jetë në stadium së paku 2 orë para fillimit të lojës, t'i paraqitet delegatit dhe gjyqtarit posa ata të arrijnë në stadium dhe nëse është nevoja edhe jashtë stadiumit, para fillimit të ndeshjës dhe pas përfundimit të saj, nëse me propozicionet e garave nuk parashihet ndryshe,

- që menjëherë pas paraqitjes së delegatit t'ia kumtojë atij gjendjen e sigurisë dhe masat e marra të sigurisë,
- që para fillimit të ndeshjes të mos lejoj persona të paautorizuar të qëndrojnë në objekte të stadiumit dhe në fushë. Përgjegjësi për siguri i klubit vendas është i obliguar që gjatë kohës sa zgjatë ndeshja të jetë në afërsi të delegatit, në mënyrë që t'i ofrojë ndihmë në eliminimin e dobësive eventuale të cilat paraqesin pengesa për zhvillimin normal të ndeshjes dhe pas përfundimit të ndeshjes të siguroj përcjelljen e personave zyrtarë dhe të ekipeve pjesëmarrëse në gara,
- të kryej punë të tjera që parashihen me akte të përgjithshme dhe Propozicione të Garave,
- përgjegjësi për siguri, duhet të ketë shenjën identifikuese ose së paku një jelek ngjyrë portokalli apo të gjelbër.

PROTOKOLI i ndeshjes

(Procesverbali i ndeshjes)

Neni 27

Për çdo ndeshje publike përpilohet Protokoli zyrtar.

Protokolin për ndeshje të garave të përhershme e formulon delegati, ndërsa në mungesë të tij e përpilon gjyqtari.

Protokoli i ndeshjes duhet gjithsesi të nënshkruhet nga personat zyrtar të të dy klubeve, përndryshe ata do të dënohen sipas Rregullores Disiplinore. Përfundimisht në ndeshjet e Superligës ku protokoli i ndeshjes shkruhet nga ana e delegatit me kompjuter dhe dërgohet në mënyrë digjitale në FFK.

Protokoli shkruhet në 4 kopje, prej të cilave: nga një kopje u dorëzohet klubeve, një organit që udhëheq me gara dhe një kopje mjeteve të informimit.

Protokoli duhet të përmbajë këto elemente: rangun e garave të ndeshjes, datën, vendin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjes, terrenin (stadiumin), emërtimet e ekipeve, përbërjen e ekipeve emrat e personave zyrtar, rezultatin e arritur përfundimtar dhe atë të pjesës së parë, zëvendësimet e bëra, emrat e lojtarëve të ndëshkuar me vërejtje publike apo të përjashtuar, emrat e lojtarëve golashënues me minutat e shënimeve, vlerësimin e delegatit dhe përfaqësuesve të dy klubeve rreth ndeshjes, deklaratat e gjyqtarit në masat disiplinore të shqiptuara dhe shkaqet, deklaratën mbi incidentet dhe trazirat, paralajmërimin e ankesës me shkaqet e saj, etj.

Me propozicione të garave mund të parashihet që në protokol të shënohen edhe të dhënat tjera, ndërsa organi që udhëheq me gara mund të caktojë formën e formularit të protokolit.

Neni 28

Lojtari i përjashtuar si dhe personat zyrtar të larguar (ndëshkuar) prej gjyqtarit, janë të obliguar që menjëherë pas përfundimit të ndeshjes t'i paraqitën delegatit dhe të japin deklaratë lidhur me rrethanat e caktuara që kanë të bëjnë me kundërvajtjen e tyre.

Lojtarët dhe personat e larguar (ndëshkuar) prej gjyqtarit janë të detyruar ta lëshojnë menjëherë fushën dhe të shkojnë në vendin e posaçëm ose në tribunë, përndryshe bëjnë kundërvajtje disiplinore dhe ndëshkohen sipas Rregullores Disiplinore.

Nëse lojtari refuzon ta jap deklaratën, atëherë duhet që brenda 48 orëve pas përfundimit të ndeshjes ta deponoj atë me shkrim në FFK, përndryshe do të konsiderohet se e ka dhënë deklaratën.

Edhe gjyqtari – asistenti i ndeshjes obligohet në dhënien e raportit lidhur me largimin – përjashtimin e lojtarit apo zyrtarit nga fusha e lojës.

Delegati në mënyrë të njëjtë do të veprojë edhe me personat zyrtar të cilët janë ndëshkuar dhe shënuar në protokol nga ana e gjyqtarit apo vëzhguesit.

Neni 29

Protokoli i ndeshjes së garave të përhershme përpilohet dhe plotësohet në lokal të posaçëm, gjithsesi në praninë e gjyqtarit, gjyqtarëve anësor, nga një përfaqësues i klubeve, delegatit dhe procesmbajtësit. Protokolin nga paragrafi 1 e këtij neni, duhet ta nënshkruajnë përfaqësuesit e autorizuar të klubeve, gjyqtari dhe delegati (për ndeshjet ku nuk aplikohet sistemi digjital).

Neni 30

Protokoli i ndeshjes është dokument publik, andaj të dhënat e shënuara në të konsiderohen të sakta gjithnjë deri sa mos të vërtetohet e kundërta.

Nëse në të dhënat e shënuara në protokol konstatohet ndonjë gabim, organi kompetent që udhëheq me gara do të bëjë përmirësimin, ashtu që protokoli i ndeshjes t'i përgjigjet gjendjes faktike. Përmirësimi i gabimeve në protokol kryhet sipas detyrës zyrtare në përputhje me të dhënat nga raportet plotësuese të gjyqtarit, gjyqtarëve ndihmës dhe delegatit të ndeshjes, si dhe kërkesën me shkrim të klubeve pjesëmarrëse në ndeshje.

Edhe klubi pjesëmarrës në ndeshje dhe palët tjera të interesuara mund të paraqesin kërkesën për përmirësimin e të dhënës së shënuar gabimisht në protokoll, përmes telefaksit apo me letër rekomanduese më së voni në afat 48 orësh nga përfundimi i ndeshjes. Një kopje të kërkesës në afat të njëjtë i dërgohet edhe klubit tjetër pjesëmarrës (respektivisht klubeve pjesëmarrëse) në ndeshje. Nuk mund të bëhen përmirësime apo ndryshime në Protokolin e ndeshjes deri sa të sjellët i njëjti në FFK.

Nëse eventualisht ndodh që në Protokolin zyrtar janë bërë lëshime dhe të cilat Komisioni Organizativ i Garave i cilëson si të paqëllimshme dhe nuk prekin në substancën e raportit atëherë ato mund të përmirësohen brenda afatit të lejuar.

Terreni Futbollistik

Neni 31

Secili terren futbollistik në të cilin zhvillohen ndeshjet publike duhet të jetë i regjistruar dhe i pranuar nga ana e organit kompetent, Komisionit për pranimin e terreneve i cili edhe e benë regjistrimin e terrenit për ndeshjet e rangut garues.

Regjistrimin e terrenit të futbollit bëhet në bazë të raportit të komisionit të posaçëm për kontrollimin dhe pranimin e terreneve, të cilin e cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Komisionin e përbëjnë tre anëtarë, njeri prej të cilëve duhet të jetë gjyqtarë apo ish gjyqtarë.

Komisioni përpilon procesverbalin mbi kontrollimin e bërë të terrenit dhe për këtë lëshon Vendim.

Komisioni për inspektimin e fushave, pas përfundimit të kampionatit (në raste të caktuara edhe më shpesh) bënë shikimin e të gjitha stadiumeve dhe vërejtjet ua paraqet zyrtarëve të klubeve të cilët janë të obliguar që t'i eliminojnë ato deri në kohën kur komisioni apo KE u jep afat për përmbushje të tyre.

Në rast se komisioni konstaton se përkundër vërejtjeve klubi nuk i ka eliminuar në tërësi vërejtjet që komisioni i ka parashtruar klubit por ata janë duke punuar në evitimin e tyre atëherë komisioni mund të bëjë sërish kontrollimin pas një jave apo në afat të cilin e cakton vetë komisioni. Shpenzimet e Komisionit do t'i faturohen klubit i cili me kohë nuk ka përmbushur kriteret.

Kur komisioni definitivit nuk e pranon një terren sportiv për garat gjegjëse, atëherë klubet kanë të drejtë të paraqesin kërkesë të serishme për inspektim por jo në afat më të shkurtër se 30 ditë nga dita e inspektimit të fundit. Shpenzimet i merr përsipër klubi aplikues.

Ankesat për parregullsinë në dimensionet e terrenit, shënimin e vijave në të, madhësinë e portave, topit të lojës etj., do të refuzohen, nëse klubi i cili ushtron atë (ankesën), para fillimit të ndeshjës, nuk i ka bërë kundërshtimin me shkrim Gjyqtarit për gjërat që theksohen në ankesë.

Nëse konstatohet se ekipi ka ndryshuar dimensionet e fushës dhe portës e të cilat nuk i përgjigjen rregullave të lojës së futbollit dhe kategorisë ku klubi bënë gara, ndaj klubit do të iniciohet procedurë disiplinore.

Nëse ka vërejtje në dimensionet e fushës, portës dhe topit vëzhguesi dhe gjyqtarët duhet me shkrim të cekin para fillimit të ndeshjës gjendjen faktike pas matjeve që kanë bërë. Nëse klubi nikoqir pas kërkesës së delegatit dhe gjyqtarit nuk i përmirëson vërejtjet e gjetura brenda 15 minutave nga koha e fillimit të lojës atëherë loja nuk do të zhvillohet dhe klubi nikoqir atë do ta humb me rezultat zyrtar.

Neni 32

Terrenet në të cilat zhvillohen ndeshjet e garave zyrtare të Kosovës, duhet të jenë të pranuar nga KE-ja, në bazë të kriterëve për infrastrukturë.

Klubi Futbollistik duhet të vërtetojë se në mënyrë ligjore ka të drejtën në shfrytëzimin e stadiumit (është pronar) ose se ka kontratë me shkrim me pronarin e stadiumit.

Sipas UEFA-së proporcionet e fushës duhet të jenë: standard për ndeshje ndërkombëtare: 105m x 68m. ose min. 100 m x 64m. (UEFA parasheh proporcionet 120 x 80 metra).

Superliga; standarde; 105 x 68 metra (maksimale; 110 x 75 minimale; 100 x 64)

Liga e parë; standarde; 105 x 68 metra (maksimale; 110 x 75, minimale; 100 x 64)

Liga e dytë; standarde; 105 x 68 metra (maksimale; 110 x 75, minimale; 100 x 60)

Liga e trete dhe kategoritë e juniorëve dhe kadetëve; standarde; 105 x 68 metra (maksimale; 110 x 75, minimale; 90 x 60 metra).

Kriteret e UEFA-së, dhe FIFA-së, parashohin edhe kriterë tjerë varësisht nga niveli i pjesëmarrjes në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Komiteti Ekzekutiv në pajtim me aktet normative të FFK-së, do të caktojë minimumin e standardeve, për terrenet në të cilat zhvillohen ndeshjet e rangut të caktuar të garave.

Vlerësimi i përshtatshmërisë së terrenit për lojë

Neni 33

Ndeshjet mund të zhvillohen vetëm në terrenin i cili është i përshtatshëm për lojë dhe i pranuar për atë rang të garave.

Ekipi nikoqir është i obliguar që ta përgatitë terrenin ashtu që të jetë i përshtatshëm për lojë, duke e përgatitur fushën, shënuar vijat, siguruar rrjetat për portë si dhe flamujt anësor.

Vlerësimi i përshtatshmërisë së terrenit duhet të bëhet në praninë e dy kapitenëve të ekipeve që do të zhvillojnë ndeshjen dhe atë, pak para kohë para fillimit të ndeshjes (kohën e fillimit e cakton organi që udhëheq me gara), përjashtimisht, kontrollimi mund të kryet edhe më herët po ditën e njëjtë dhe atë me kusht që ai të kryhet në praninë e dy kapitenëve dhe gjyqtarit.

A është terreni i përshtatshëm për lojë apo jo, për shkak të ndikimit të kushteve atmosferike dhe shkaqeve tjera që radhiten në fuqi madhore, vendos gjyqtari i cili është i caktuar të drejtojë ndeshjen. Gjyqtari nuk do ta fillojë ndeshjen:

a. nëse terreni për lojë nuk është vizatuar shiqueshëm dhe drejtë, si dhe rekuizitat elementare (rrjetat, portat, flamujt etj.) të terrenit nuk kanë qenë të vendosura drejtë dhe në mënyrë të rregullt,

b. nëse terreni për lojë është i mbuluar me baltë dhe ujë të cilët e pengojnë lëvizjen e lojtarëve dhe topit,

c. nëse terreni për lojë është i ngrirë dhe ekziston mundësia e lëndimit të pjesëmarrësve të lojës,

d. nëse terreni për lojë është i mbyllur me borë, lartësia e së cilës pamundëson lëvizjen e lojtarëve, topit dhe gjyqtarëve (e vërtetohet se organizata është angazhuar që terrenin ta aftësoi për ndeshje,

e. nëse për shkak të mjegullës nuk shihen portat nga vija e mesit të fushës,

f. si dhe shkaqe tjera të arsyeshme.

Gjyqtari dhe vëzhguesi janë të obliguar që në protokol të cekin shkakun e marrjes së vendimit përshtatshmërinë e terrenit dhe protokol të ia dorëzojnë udhëheqsisë së garave në afat prej 24 orëve, me informimin paraprak.

LOJTARËT: numri më i vogël dhe zëvendësimet

Neni 34

Ndeshja nuk mund të fillojë nëse njëri prej ekipeve ka më pak se 7 lojtarë.

Lojtarët të cilët nuk fillojnë ndeshjen kanë mundësi të hyjnë në lojë deri në fund të ndeshjes, por që paraprakisht janë shënuar në protokoll si lojtar apo rezervë.

Neni 35

Nëse një ekip gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes mbetet më pak se 7 lojtarë, gjyqtari është i obliguar që ndeshjen ta ndërpresë po që se ekipi nuk është në gjendje që brenda 5 minutave të sigurojë numrin e nevojshëm të lojtarëve.

Zëvendësimet për shkak të rrethanave me pandeminë COVID-19

Ndryshim i përkohshëm

Neni 36

Për të gjitha ndeshjet e luajtura në konkurrim zyrtar; meshkuj, femra (ndeshjet kampionale dhe të Kupës):

1. Gjatë ndeshjes secili ekip;

- mund të përdor një maksimum prej 5 zëvendësimeve.

- ka maksimalisht tri ndalesa zëvendësimi.

- mund të bëjë zëvendësime në pushim, ndërmjet dy pjesëve (nuk llogaritet si ndalesë zëvendësimi).

2. Kur luhet koha shtesë (p.sh. ndeshjet e kupës secili ekip);

- Mund të përdor një zëvendësim – shtesë (një të gjashtin, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimeve).

- Ka një ndalesë shtesë zëvendësimi (një të katërt, pavarësisht nëse skuadra ka përdorur numrin maksimal të ndalesave të zëvendësimit).

Mund të bëjë zëvendësime shtesë;

a) Në periudhën para fillimit të kohës shtesë.

b) Në periudhën ndërmjet dy kohëve shtesë.

Nëse një ekip nuk ka përdorur numrin e tij maksimal të zëvendësimeve ose ndalesave të zëvendësimit, zëvendësimet dhe ndalesat e përdoruara mund të përdoren në kohën shtesë. Kur të dy ekipet bëjnë një zëvendësim në të njëjtën kohë, kjo do të llogaritet si një mundësi zëvendësimi e përdorur për secilin ekip.

Zëvendësimet të grup moshat e reja;

- Në ndeshjet e U-19, U-17, në njërin ekip mund të zëvendësohen më së shumti pesë (5) lojtarë, kurse të U-15, U-13 dhe U-11 në njërin ekip mund të zëvendësohen më së shumti 7 lojtarë.

- Zëvendësimet mund të kryhen vetëm me lojtarë të cilët para ndeshjes janë evidencuar në protokol, e ata mund të jenë më së shumti **12 (dymbëdhjetë)**.

FANELAT:

Neni 37

Ekipet në një ndeshje, nuk mund të luajnë më fanela të ngjyrave të njëjta apo të ngjashme. Kompetent për vlerësimin e këtij elementi është gjyqtari kryesor, i cili edhe e merr vendimin përfundimtar lidhur me këtë.

Nëse ekipet, fanelat tradicionale i kanë me ngjyrë të njëjtë apo të ngjashme, atëherë ekipi mysafir është i obliguar që të ndërrojë fanelat, në të kundërtën, nëse ndeshja nuk do të mund të zhvillohet për këtë arsye, ajo do të regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0 në favor të ekipit nikoqir.

Para fillimit të Kampionatit, me rastin e licencimit në FFK, ekipet janë të obliguara të njoftojnë organin që udhëheq me gara për ngjyrat ato tradicionale dhe rezervë (3 palë fanela)me të cilat do të luaj në atë kampionat.

Më së voni 15 ditë para fillimit të vitit garues, organi gjegjës i gjyqtarëve të futbollit të FFK-së, është i obliguar të shpallë ngjyrën rezervë të fanelave të gjyqtarëve. Ngjyra e paraqitur e fanellave e klubeve qartas duhet të ndryshojë nga ngjyra zyrtare e fanelave të gjyqtarëve.

Gjyqtarët janë të obliguar që në ndeshje të disponojnë me fanelat rezerve.

Neni 38

Gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjës, lojtarët në pjesën e mbrapme (shpinë) të fanelave të veta, duhet të kenë numrat e dukshëm të madhësisë së caktuar me dispozita.

Lojtarët e ekipeve senior të të gjitha rangjeve garuese, duhet të identifikohen me numër të vetëm në fanelë gjatë gjithë edicionit garues (numër me të cilin edhe licencohet për gara). Numrat për licencim mund të jenë nga; 1 – 99.

Numrat në fanela duhet të përputhën me numrat në regjistrin e lojtarëve të shënuar me protokolin e ndeshjës. **Në të kundërtën konsiderohet se lojtari është aktivizuar pa të drejtë, dhe pasojnë masat sipas dispozitave të akteve normative të FFK-së.**

Gjithashtu, iniciohet procedurë disiplinore ndaj lojtarit, përfaqësuesit zyrtar, klubit, referit të katërt dhe delegatit të ndeshjës dhe pasojnë dënimet me të holla.

Nëse lojtari përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 29, paragrafin 1 të Propozicioneve të Garave, konkretisht identiteti i lojtarit nuk është kontestues, mirëpo eventualisht ndodhë që në protokol zyrtar të ndeshjës lojtari evidentohet me një numër të caktuar të fanelës, ndërsa në fushë lojtari ka numër tjetër të fanelës, atëherë do të konsiderohet si gabim – lëshim teknik e jo lëshim substancial dhe ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur në fushë.

Dispozitat të cilat më për së afërmi do të rregullojnë ngjyrën e ndërresave (fanelave, shorceve, mbathjes), numrave (madhësisë) etj., do të caktohen me akt të posaçëm normative të Komitetit ekzekutiv të FFK-së.

ORGANIZIMI I NDESHJËS

Neni 39

1. Organizimin e ngjarjeve sportive e bënë Federata e Futbollit e Kosovës.
2. Organizimin e ngjarjeve sportive mund ta bëjnë klubet sportive, organizatat e sportisteve shoqatat e sportisteve edhe personat fizikë apo juridikë që paraprakisht kanë bërë marrëveshje me Federatën e Futbollit të Kosovës.
3. Organizatori i ngjarjeve sportive është i obliguar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e ngjarjes sportive, e në veçanti duhet te kujdeset për masat parandaluese të shfaqjes së dhunës dhe sjelljeve të palejuara.
4. Po ashtu organizatori i ndeshjës duhet të ndërmerr të gjitha masat për parandalimin e të gjitha veprimtarive që pengojnë zhvillimin e ndeshjës (punimet e ndryshme apo veprimtaritë tjera) brenda perimetrit të stadiumit.
- 5. Organizatori i ndeshjës është i detyruar të ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen dhe sigurimin e komplet pajisjeve të sistemit të VAR-it. Nëse vjen deri tek dëmtimi i pajisjeve të VAR-it, Komisioni Organizativ i Garave do të inicojë procedurë tek Komisioni Disiplinor dhe i Etikës.**

Të gjithë organizatorët e ngjarjeve sportive në futboll përpos që implementojnë dispozitat obligative nga aktet normativ e të FFK-së, iu nënshtrohen edhe **Ligjit përkatës** mbi parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në sport e sidomos në kapitujt:

- Dhuna, sjelljet e palejuara, kurdisjet dhe dukuritë negative në ngjarjet sportive,
- Masat organizative,
- Masat preventive,
- Obligimet e organizatorit në ngjarjet sportive me rrezikshmëri të lartë,
- Obligimet e organizatorit për mbajtjen e evidencave përkatëse,
- Obligimet e organizatorit për sigurimin e kushteve teknike,
- Masat të cilat i ndërmarrin organet shtetërore kompetente,
- Bartja e shpenzimeve lidhur me masat e shqiptuara,
- Masat disiplinore dhe direktivat,
- Masat disiplinore kundër anëtarëve dhe klubeve, etj...

Neni 40

Të gjitha subjektet pjesëmarrëse ose anëtare në gara duhet t'i përmbahen dhe nënshtrohen kësaj rregulloreje dhe akteve tjera normative të FFK-së, ashtu që të shmangin çdo sjellje që mund të dëmtojë apo cenojë integritetin e garave, ndeshjeve ose aktiviteteve tjera që lidhen me FFK-në.

Ndalohen të gjitha sjelljet e subjekteve pjesëmarrëse ose anëtare në gara dhe aktivitete të FFK-së, që kanë të bëjnë me:

- Bixhozin ose vënien e basteve në: ndeshjet, garat apo aktivitetet në të cilat marrin pjesë dhe/ose ndeshjet, garat apo aktivitetet në të cilat kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthorët,
- Shpërndarjen e informacionit të brendshëm të FFK-së,
- Sjelljet përmes të cilave subjektet pjesëmarrëse ose anëtare kërkojnë të ndikojnë në rezultatin e ndeshjes për të fituar një avantazh për vetën ose të tjerët,

Obligimet e subjekteve pjesëmarrëse ose anëtare në gara dhe aktivitete të FFK-së janë:

- Të raportojnë dhe refuzojnë të gjitha qasjet për trukim të ndeshjeve, kurdo që kanë informatë për trukimin e ndonjë ndeshje duhet të lajmërojnë organin përkatës të FFK-së. Moskallëzimi përbënë shkelje disiplinore.

- Të raportojë menjëherë tek FFK për ndonjë sjellje që përbën shkelje të akteve normative të FFK-së, për të cilën është në dijeni.

Neni 41

Dispozitat mbi organizimin e ndeshjës dhe rendin në stadiumi gjatë zhvillimit të ndeshjës caktohen me Propozicionet e garave dhe nenet e cekura më lart në këtë Rregullore të garave të lojës së futbollit. Organizatori i ndeshjës është i obliguar të organizojë zhvillimin e saj në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Për organizimin e ndeshjës përgjegjës është ekipi nikoqir

Neni 42

Organizatori i ndeshjës është klubi i parë (nikoqiri) i shënuar në orarin e ndeshjeve.

Detyrat e organizatorit të ndeshjës janë të përshkruara në nenin 39 të kësaj rregulloreje:

- të sigurojë shërbimin e nevojshëm mjekësor,
- të sigurojë shërbimin gjegjës të sigurisë (Policinë e Kosovës),
- që ekipit mysafir t'i ofrojë dhe sigurojë mikpritje dhe lokal për qëndrim para dhe pas përfundimit të ndeshjës një gjë e tillë është nevojshme,
- që personave zyrtar (nëse ata nuk jetojnë në vendin ku zhvillohet ndeshja), me kërkesën e tyre t'iu sigurojë lokal qëndrimi, ashtu siç parashohin propozicionet e garave,
- të ndër marrë të gjitha masat për organizimin dhe sigurimin e ndeshjës.

Me propozicionet e garave mund të rregullohet më për së afërmi mënyra e kryerjes së obligimeve nga paragrafi i mëparshme si dhe obligimet tjera të organizatorit të ndeshjes.

Ndeshjet publike

Neni 43

Me ndeshje publike nënkuptohen të gjitha ndeshjet e garave të përhershme si dhe ndeshjet miqësore dhe turnetë që i organizojnë klubet, organizatat sportive etj.

Ndeshjet miqësore publike dhe turnetë organizohen sipas dispozitave të cilat vlejné për gara të përhershme dhe dispozitave të posaçme që parashihen me këtë rregullore. Persona që bëjnë lëshime dhe kundërvajtje eventuale në ndeshje publike, mirën në përgjegjësi sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së.

Ndeshjet **përgatitore** nuk konsiderohen si ndeshje publike. Në këto ndeshje nuk vlejné kufizimet lidhur me të drejtën e lojës dhe ndalesën e lojës, me marrjen pjesë të lojtarëve nga klubet tjera, me numrin e ndërrimeve që mund të bëhen në ndeshje etj.

Në këto ndeshje nuk mbahet protokoli dhe nuk i paraqitet raporti organit kompetent të futbollit, madje edhe rastet kur ato i drejton gjyqtari i papërvojë.

Neni 44

Në ndeshjet e garave të përhershme mund të luajnë vetëm lojtarët të cilët kanë fituar të drejtën e lojës për klubin e vet dhe para ndeshjës janë të shënuar në protokoll si lojtarë apo rezervë.

Gjithashtu në ndeshjet të caktuara publike mund të luajnë si mysafir edhe lojtarët e klubeve tjera sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Ndeshjet miqësore dhe turnetë

Neni 45

Çdo ndeshje miqësore duhet t'i paraqitet Komisionit kompetent. Paraqitja e ndeshjës si dhe kërkesa për gjyqtarë duhet të bëhet së paku 8 ditë para ndeshjës, ndërsa për raste të arsyeshme 48 orë para ndeshjës. Arësyeshmërinë e kërkesës e vlerëson organi kompetent.

Kartoni i kuq direkt dhe rastet apo incidentet e lajmëruara në komision përkatës, vlejné sikurse edhe në ndeshjet e tjera zyrtare.

Klubi i cili nuk u përmbahet këtyre dispozitave, është përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së. Çdo klub duhet të ketë lejen e organit kompetent për organizimin e Turneut.

Lejen nga paragrafi paraprak e jep Komiteti Ekzekutiv respektivisht organi që e autorizon ai, dhe atë:

- për turne në të cilat merr pjesë një apo më shumë klube të huaja dhe ekipet e Superligës, Ligës së I-rë, Ligës së II-të, lejen e jep Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.
- Për të gjitha turnetë tjera, duke i përfshirë edhe turnetë e klubeve të të gjitha rangjeve garuese, lejen e jep organi kompetent i cili udhëheq me gara.
- Për turnetë tradicionale të futbollit vendos KE me vendim te posaçëm dhe vendos se a do ta futë turneun e tillë në kalendarin zyrtarë të garave dhe a do ta merr përsipër organizimin e tyre. Kërkesën për lejimin e turneut duhet bërë më së voni 15 ditë, para ditës së paraparë për fillimin e turneut. Kërkesës duhet bashkangjitur edhe propozicionet e garave të turneut.

Për turne ndërkombëtare, klubi organizator, kërkesën për lejimin e turnesë duhet ta paraqesë së paku dy muaj e gjysmë para zhvillimit (fillimit) të turneut, kërkesës duhet bashkangjitur propozicionet e turneut dhe regjistrin e pjesëmarrësve.

Neni 46

Për fillimin e ndeshjës ndërkombëtare në vend apo jashtë vendi duhet të ketë lejen e organit kompetent të futbollit.

Lejën nga al. 1 e këtij neni e jep Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, respektivisht organi që e autorizon ai, dhe atë:

- a. Për ndeshjet e klubeve të Superligës, Ligës së parë dhe të dytë, lejen e jep Komiteti Ekzekutiv apo organi që e autorizon ai,
- b. Për ndeshjet e klubeve tjera si dhe për ekipe të rinjëve, kadetëve, pionierëve, pastaj për ndeshjet e klubeve të ligës së tretë, lejen e jep Komisioni i Garave gjegjëse.

Nëse leja kërkohet për periudhën kur zhvillohen ndeshjet kampionale apo për kupë, ndërsa me ato gara udhëheqin organet tjera, atëherë klubi është i obliguar që më parë të merr pëlqimin nga organi kompetent i cili udhëheq me gara.

FFK, me rregullore të veçantë më për së afërmi përcakton kushtet për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare.

Në afat prej 8 ditëve nga dita e kthimit nga jashtë, klubi është i obliguar që organit i cili i ka dhënë lejen për shkuarje jashtë vendit, t'i paraqesë raport mbi qëndrimin jashtë vendit.

Nëse ndonjë lojtar është përjashtuar në ndeshjet jashtë vendi, klubi është i obliguar që në afat prej tri ditëve nga kthimi të paraqes raportin dhe deklaratën e përfaqësuesve të klubit dhe lojtarëve të përjashtuar.

Neni 47

Lojtari i regjistruar në një klub mund të luajë si mysafir në ndeshje miqësore të klubit tjetër, vetëm nëse disponon lejen me shkrim të lëshuar nga klubi i vet.

Neni 48

Në turnetë ndërkombëtare dhe ndeshjet ndërkombëtare në klubet e vendit dhe të huaja, mund të luajnë si mysafirë lojtarët e klubeve tjera, por me pëlqimin e klubit të vet dhe lejen paraprake të organit kompetent të FFK-së.

Kundër lojtarit dhe klubit i cili nuk e **respekton dispozitën e paragrafit paraprak** do të zhvillohet procedura disiplinore sipas dispozitave të FFK-së.

Neni 49

Në ndeshjet ndërkombëtare reprezentative në vend dhe jashtë vendit, jashtë suazave të FFK-së (si reprezentacionet e studentëve, shkollave të mesme, sindikatave etj.) mund të luajnë edhe lojtarët e regjistruar anëtare të FFK-së, të Superligës, Ligës së I-rë, II-të **dhe ligave të grup moshave të reja** por vetëm me lejen paraprake të klubit dhe/ose lidhjet rajonale.

Lojtarëve të huaj, klubi për të cilin janë regjistruar, duhet t'ua lejojë paraqitjen për reprezentacionin e tyre nacional, sipas Rregullores mbi statusin dhe transferin e lojtarëve të FIFA-së.

Neni 50

1. Në ekipin e U-19 (mosha 17 - 19 vjeç) të drejtë paraqitje, në edicionin e garave 2023-2024 kanë lojtarët që kanë lindur me 01.01.2005 e më të rinjë. Më të rinjë se 17 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale respektivisht FFK-së.

2. Në ekipin e U-17 (mosha 15 - 17 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2023-2024 kanë lojtarët që kanë lindur me 01.01.2007 e më të rinjë. Më të rinjë se 15 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale të FFK-së.

3. Në ekipin e U-15 (mosha 13 – 15 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2023-2024 kane lojtarët që kanë lindur me 01.01.2009 e më të rinjë. Më të rinjë se 13 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale të FFK-së.

4. Në ekipin e U-13 (mosha 11–13 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2023-2024 kanë lojtarët qe kane lindur me 01.01.2011 e më të rinjë. Më të rinjë se 11 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale të FFK-së.

5. Në ekipin e U-11 (mosha 9 – 11vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2023-2024 kanë lojtarët qe kane lindur me 01.01.2013 e më të rinjë. Më të rinjë se 9 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale të FFK-së.

6. Në ekipin e U-9 (mosha 7 - 9 vjeç) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2023-2024 kanë lojtarët që kanë lindur me 01.01.2015 e më të rinjë. Më të rinjë se 7 vjeç mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar - vulosur në Lidhjet Rajonale të FFK-së.

Nëse klubi luan në ndeshje publike me lojtar i cili nuk i plotëson kushtet e sipërshënuara, atëherë klubi dhe lojtari janë përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së, me atë që klubi do të bartë edhe pasojat tjera të parapara me këtë Rregullore.

LOJTARI NUK MUND TË LUAJ BRENDA 48 ORËVE NË DY NDESHJE ZYRTARE

Neni 51

Lojtarët e një klubi që garon në të njëjtën kategori me dy ekipe (A, B) nuk mund të luajnë në të njëjtin rang garash, pa kaluar nga njëri në tjetrin ekip (A, B) në afatin kalimtar të lojtarëve verore apo dimërore.

Një ekip seniorësh mundet që gjatë një stinorit futbollistik t'i licencojë për gara maksimum 35 futbollistë. Këtu nuk llogariten juniorët e ekipit vetanak të cilët kanë të drejtë loje në çdo kohë për ekipin e seniorëve dhe ekipin B të klubit përkatës.

Po ashtu lojtarët e ekipeve B të Superligës së Kosovës të licencuar në fillim të sezonit futbollistik mund të paraqiten në çdo kohë për ekipin amë, si edhe ata të ekipit A për ekipin B (senior dhe junior nëse plotësojnë kushtet e moshës për aktivizim).

Nëse klubi luan në ndeshje publike me lojtarin i cili brenda katërdhjetë e tetë orëve (48), ka luajtur më parë, do të konsiderohet si paraqitje e parregullt e lojtarit dhe ndeshja sipas ankesës do të regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0 për parashtruesin e ankesës, respektivisht për palën e tretë që ka interes në këtë ndeshje, si dhe do të hapet procedura disiplinore ndaj:

- Klubit dhe lojtarit

Në garat e përhershme të FFK-së, lejohen të regjistrohen pa kufizim lojtarë me shtetësi të huaj, të regjistruar për një klub futbollit, kurse me të drejtë paraqitje në protokol zyrtar dhe të drejtë loje janë si në vijim:

Për Superligë, maksimum 6 lojtarë të huaj mund të paraqiten në protokol me të drejtë lojë.

Në Ligën e parë dhe Ligën e dytë, 5 lojtarë të huaj mund të paraqiten në protokol zyrtarë me të drejtë loje.

Ndërsa për Ligat e tjera dhe te kategoria e juniorëve; mund të paraqiten 2 (dy) lojtarë shtetas të huaj në protokol me të drejtë loje.

Edhe në Ligën e futbollit të femrave - Seniorët, lojtare të huaja maksimum 4 lojtare mund të paraqiten në protokol zyrtar me të drejtë loje.

Lojtar/Lojtare shtetas të huaj nuk konsiderohen lojtaret nga Republika e Shqipërisë.

Neni 52

Nëse me vendimin e organit kompetent është caktuar që të përsëritet ndeshja e garave të përhershme, në ndeshjen e re mund të luajnë të gjithë lojtarët që kanë të drejtë loje në ditën e zhvillimit të ndeshjës së re.

Vërtetimi i identitetit të lojtarëve

Neni 53

Në ndeshjet kampionale dhe për KUPË, mund të luajnë të gjithë lojtarët identiteti i të cilëve vërtetohet përmes ID kartelave, të lëshuara nga ana e organit kompetent për regjistrimin e lojtarëve, por në mungesë të ID Kartelës, identiteti i tyre vërtetohet përmes letërnjoftimit apo dokumentit të udhëtimit (pasaportës) dhe përjashtimisht lojtari fotografohet para fillimit të ndeshjës nga delegati.

Identitetin e lojtarëve dhe atyre rezervë vërteton delegati në praninë e përfaqësuesve të klubeve para fillimit të ndeshjës, ndërsa pas përfundimit vetëm për ata lojtarë rezervë të cilët nuk kanë arritur në fillim të ndeshjës.

Mënyra e vërtetimit të identitetit për lojtarë të kategorisë së pionierëve dhe të rinjëve, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë ID kartela të futbollit apo letërnjoftime para ndeshjës, rregullohet me propozicionet e garave gjegjëse.

Përjashtimisht nga dispozitat në paragrafet e sipërsënuara, mund që në rrezik vetanak të angazhohë në ekip lojtarin i cili nuk e ka ID kartelën apo letërnjoftimin ose dokumentin e udhëtimit, por me kusht që identiteti i këtij lojtari të vërtetohet më së voni 15 min. pas përfundimit të ndeshjës dhe ajo të konstatohet në protokolin e ndeshjës.

Me Propozicionet e garave gjegjëse, mund të caktohet edhe mënyra plotësuese e vërtetimit të identitetit të lojtarit.

Kontrollimi mjekësor i lojtarëve

Neni 54

Kontrollimi mjekësor është i obliguar të kryhet para fillimit të çdo sezone d.m.th. 2 herë në vit, çdo 6 muaj. Kontrollimi mjekësor për çdo gjysmë sezoni është i obligueshëm edhe për ata lojtarë të cilët regjistrohen në mes të sezonit.

Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor për lojtarë zgjatë 6 muaj.

Kontrollimi special mjekësor për lojtarë të rinj (U-17) që do të luajnë në ekipin e parë vlen 6 muaj.

Me kontrollim mjekësor special derisa ai është i vlefshëm, lojtari mund të luaj në të gjitha ndeshjet, vetëm nëse e ka në ID-kartelën me vërtetimin e lëshuar dhe e vulosur nga organi i Mjekësisë Sportive ose QKMF respektive. Klubet janë të obliguara t'i përmbahen në tërësi neneve përkatëse të Rregullores së garave sa i përket kontrollimit mjekësor dhe personelit mjekësor.

Lojtari i cili nuk është kontrolluar nga mjeku në afatin e caktuar ose të cilit i është ndaluar e drejta për lojë nga ana e mjekut ose gjendet në pushim mjekësor si dhe lojtarëve të cilëve pa kontrollimit mjekësor mjeku nuk i ka lëshuar vërtetimin mbi kryerjen e kontrollimit mjekësor, nuk mund të luaj (paraqitet) në ndeshjet publike.

Në raste të posaçme, lojtari për të cilin në mungesë të ID kartelës së futbollit nuk mund të vërtetohet se e ka kryer kontrollimin mjekësor ose në mungesë të vërtetimit mbi kontrollimin mjekësor, klubi mund të angazhohë atë në ekip në përgjegjësi

vetanake, me atë që në afatin prej 24 orëve nga përfundimi i ndeshjës t'ia dorëzoj organit garues ID kartelën e futbollit e cila dëshmon mbi kontrollimin mjekësor ku pa kurrfarë dyshimi mund të vërtetohet se lojtari ka pasur të kryer kontrollimin mjekësor të vlefshëm për ndeshjën e cekur kampionale ose KUPËS.

Ndaj delegatit të ndeshjës i cili lejon një gjë të tillë do të ngritët procedura disiplinore. Po ashtu, procedurë disiplinore do të ngritët ndaj, lojtarit, klubit dhe zyrtarit i cili lejon paraqitjen e lojtarit në ndeshje që nuk kanë kontrollim mjekësor të kryer valid, konform rregullores së garave.

Kontrollimi mjekësor i lojtarëve duhet të kryhet në institucionin shëndetësor sportiv (nëse ka) apo në institucione publike shëndetësore ose private nëse Komisioni Mjekësori FFK-së, i pranon si të afta për kryerjen e kontrollimit mjekësor.

Klubet duhet të dorëzojnë pranë Komisionit mjekësor të FFK-së, regjistrin e lojtarëve të cilët kanë kryer kontrollimin mjekësor, të atyre të cilët kanë rezultuar të aftë për gara dhe të atyre të cilët nuk kanë marrë lejen për garim nga Komisioni mjekësor.

Lojtarët të cilët gjatë kontrollimit mjekësor një herë kanë dalë si të pa aftë për gara duhet të bëjnë kërkesë Komisionit Mjekësor të FFK-së, për përsëritje të procedurës së kontrollimit mjekësor dhe një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm pasi që komisioni të këtë lejuar ri kontrollimin mjekësor.

Në gara mund të merr pjesë pasi ta këtë kaluar me sukses kontrollimin mjekësor.

Përsëritja e procedurës për ri-kontrollim mjekësor nuk mund të behët pa kaluar së paku 15 ditë nga dita e kontrollimit mjekësor.

Në të gjitha ndeshjet kampionale, **të Superligës dhe Ligës së Parë, klubet** janë të obliguara të kenë fizioterapeut dhe mjekun e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Asnjë ndeshje e asnjë kategorie **tjetër** të futbollit në kuadër të FFK-së, nuk mund të zhvillohet nëse njëri klub nuk e ka së paku fizioterapeutin ose mjekun prezent, dhe të gatshëm për dhënien e ndihmës mjekësore.

Nëse klubi nuk posedon as mjekun as fizioterapeutin për dhënien e ndihmës mjekësore, ndeshja nuk mund të zhvillohet, ndërsa ekipi i tillë e humb ndeshjën me rezultat zyrtar.

Në raste të jashtëzakonshme kur për shkaqe të ndryshme as mjeku as fizioterapeuti nuk kanë arritur me kohë në stadium ata mund të priten më se shumti 15 minuta nga koha kur është dashur të zhvillohet ndeshja.

Delegati i ndeshjës duhet të shënojë saktë në protokol arsyen për vonesë ose për mos zhvillim të ndeshjës.

Kundër klubeve dhe lojtarëve të cilët shkelin dispozitat paraprake, do të iniciohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së.

Si vërtetim zyrtar në kuptim të paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni konsiderohet vërtetimi i dhënë në bazë të regjistrit zyrtar mbi kontrollimin e kryer mjekësor.

Përrjashtim bëjnë kategoritë e reja (kadetë dhe më të rinjë) ku ekipi nikoqir është i obliguar që të ketë mjekun apo fizioterapeutin e licencuar. Sugjerohet fuqishëm që edhe ekipi mysafir ta ketë mjekun. Nëse ekipi vendas nuk e ka as mjekun e as fizioterapeutin e licencuar, atëherë humb ndeshjen me rezultat zyrtar.

Neni 55

Klubi nikoqir është i obliguar që të siguron shërbimin mjekësor në të gjitha ndeshjet publike dhe të njoftoj me shkrim qendrën shëndetësore më të afërt për zhvillimin e ndeshjes.

Shërbimi mjekësor duhet të jetë i siguar së paku 30 minuta para fillimit të ndeshjes, respektivisht gjatë ndeshjes dhe 30 minutat pas përfundimit të ndeshjes.

Klubet janë të obliguara që para fillimit të çdo stinori në FFK, të sjellin kartonët shëndetësor të lojtarëve me evidencë të kontrollës së kryer mjekësore në entet e mjekësisë sportive apo qendra tjera shëndetësore të konfirmuara dhe lejuara nga FFK-ja.

Ky rregull vlen edhe për ndeshjet e ekipeve të juniorëve dhe kategorive tjera që bëjnë gara në kuadër të FFK-së.

Neni 56

Nëse në afat prej 30 minutave nga koha e caktuar për fillimin e ndeshjes të garave të përhershme, nuk paraqitet njëri ekip me numër të mjaftueshëm të lojtarëve. Gjyqtari do t'i komunikojë kapitenit të ekipit i cili është paraqitur, se ndeshja nuk do të zhvillohet dhe atë do të konstatojë në protokolin e ndeshjes.

Organi i cili udhëheq me gara ndeshjen do ta regjistrojë me rezultat zyrtarë 3:0 (parforfe) nëse konstaton se mosardhja e ekipit në ndeshje është e paarsyeshme.

Mos zhvillimi dhe ndërprerja e ndeshjes

Neni 57

Nëse klubi nikoqir nuk e ka aftësuar terrenin për lojë për shkaqe të paarsyeshme para fillimit ose gjatë zhvillimit të ndeshjes, ndërsa gjyqtari vendos që ndeshja nuk mund të fillojë ose ndeshja e ndërprerë të mos vazhdojë duhet të konstatohet në protokol, se është përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së, ndërsa ndeshja regjistrohet me rezultat 3:0 (parforfe) në të mirë të ekipit kundërshtar (nëse vërtetohet se ekipi nikoqir nuk ka ndërmarrë masat e duhura për zhvillimin e ndeshjes zyrtare cilat janë shkaqe teknike jo fuqi madhore).

Nëse ndeshja e garave të përhershme, është ndërprerë për shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të evitohen (koha e keqe, mjegulla, terri, zjarri, tërmeti etj.), për çka

vendos gjyqtari, ndeshja do të zhvillohet ditën e nesërme në të njëjtën kohë (nëse ka kushte) nga ajo minutë në të cilën ka ardhur deri te ndërprerja e ndeshjës.

Ekipi i cili nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjës së re, të cilën e cakton organi kompetent, përgjigjet sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së, ndërsa ndeshja do të regjistrohet me rezultat 3:0 (parforfe) në favor të kundërshtarit.

Vendimin mbi regjistrimin e ndeshjës me rezultat 3:0 (parforfe) nga al. 1 dhe 4 e këtij neni e merr organi i cili udhëheq me gara, sipas detyrës zyrtare.

Nëse të dy ekipet pa arsye nuk paraqiten për zhvillimin e ndeshjës së re, konsiderohet se nuk janë të interesuara t'i vazhdojnë garat e mëtutjeshme, andaj bartin pasojat e parapara me akte të përgjithshme normative të FFK-së.

Neni 58

Ekipi i cili e lëshon terrenin, respektivisht ekipi i cili shkakton ndërprerjen e ndeshjës, duke përfshirë edhe ndërprerjen e ndeshjës që e ka shkaktuar lojtari i asaj ekipe, humbë ndeshjën me rezultat 3:0 (parforfe), nëse deri te ndërprerja kundërshtari nuk ka arritur rezultat më të mirë.

Vendimi mbi regjistrimin e ndeshjës me rezultat 3:0 (parforfe) e merr organi i cili udhëheqë me gara, sipas detyrës zyrtare.

Ekipi i cili është shkaktar i ndërprerjes së ndeshjës, i nënshtrohet edhe masave ndëshkuese disiplinore të parapara me Rregulloren Disiplinore.

Neni 59

Nëse ndeshja është ndërprerë për shkak të incidentit, trazirave, numrit jo të mjaftueshëm të lojtarëve, mosrespektimit të vendimit të gjyqtarit për përjashtimin e lojtarit dhe largimin e tij prej terreni, etj., e po qesë vërtetohet se për ndërprerje të ndeshjës fajtor është njëri prej ekipeve pjesëmarrëse, ekskluzivisht apo në pjesën dërmuese, ndeshja do të regjistrohet me rezultat 3:0 (parforfe) në favor të ekipit kundërshtar, me kusht që deri në ndërprerjen e ndeshjës nuk ka arritur rezultat më të mirë.

Nëse organi që udhëheqë me gara e vërteton se për ndërprerje të ndeshjës, nuk është fajtor asnjëri prej ekipeve pjesëmarrëse, respektivisht për ndërprerjen janë fajtor në mënyrë të barabartë të dy klubet dhe se organizatori i ndeshjës ka ndërmarrë të gjitha masat e parapara me dispozitat e FFK-së, rreth organizimit dhe sigurimit dhe rendi në ndeshje të rangut të caktuar të garave atëherë organi kompetent mund të vendos që të zhvillohet ndeshja e re ose ndeshja e ndërprerë të regjistrohet me rezultatin e arritur.

Në rast të ndërprerjes së ndeshjës për shkak të trazirave apo incidentit serioz, organi i cili udhëheqë me gara mund ta suspendojë ekipin fajtor që mos t'i zhvillojë ndeshjet e garave të përhershme në stadiumin e caktuar apo në stadiumet e territorit të caktuar.

Ndalesa për të luajtur për shkak të suspendimit dhe pasojat

Neni 60

Ekipi i suspenduar, respektivisht të gjithë lojtarët e klubit të suspenduar, nuk mund të luajnë në ndeshje publike derisa zgjatë suspendimi.

Të gjitha ndeshjet të cilat janë të parapara gjatë kohës së suspendimit të shqiptuar, e të cilat ekipi i suspenduar nuk i zhvillon për shkak se nuk i ka përmbushur obligimet që rrjedhin nga vendimet e plotfuqishme të organeve kompetente të FFK-së, ose për shkak të mos përmbushjes së obligimeve tjera që rrjedhin nga vetë zhvillimi i garave, do të regjistrohen me rezultat 3:0 (parforfe) në favor të kundërshtarit.

Ndeshjet të cilat ekipi i suspenduar nuk ka mundur t'i zhvillojë gjatë kohës së suspendimit të shqiptuar, për shkak se duhet bërë vërtetimin e gjendjes faktike, e cila është e domosdoshme për marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me ndonjë rast kontestues, nuk do të regjistrohen derisa mos të merret vendimi përfundimtar. Pas marrjes së vendimit përfundimtar, klubi është i obliguar t'i zhvillojë ndeshjet sipas orarit që e përcakton organi kompetent për udhëheqjen me gara.

Nëse ekipi i suspenduar luan në ndeshje publike, atëherë ndaj tij do të iniciohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore, po ashtu klubi do të bartë edhe pasojat garuese nëse lidhur me ndeshjën e zhvilluar është ushtruar ankesa sipas dispozitave të kësaj Rregullore.

Tërheqja nga garat dhe fuzionimi i klubeve

Neni 61

Nëse Klubi, gjatë zhvillimit të Kampionatit me vetëdëshirë tërhiqet nga garat e mëtutjeshme, apo Komisioni Organizativ i Garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve (për Senior) dhe tri ndeshjeve (për kategoritë e reja), apo për arsye tjera të parapara me Rregullore Disiplinore, atëherë ai Klub do të fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të duhej t'i zhvillonte veprohet me sa vijon:

Në qoftë se, një ekip me vetëdëshirë largohet nga garat e mëtutjeshme apo Komisioni Organizativ i Garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve, atëherë ai ekip do të fshihet nga garat e mëtutjeshme.

Për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të zhvillonte do të veprohet me sa vijon:

- Nëse klubi tërhiqet ose përjashtohet nga garat pasi që të ketë zhvilluar gjysmën e ndeshjeve apo më pak nga numri i përgjithshëm i ndeshjeve të parapara për tërë kampionatin, atëherë të gjitha ndeshjet e tij të zhvilluara anulohen,
- Nëse klubi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi të ketë zhvilluar më tepër se gjysmën e numrit të përgjithshëm të ndeshjeve të parapara për atë kampionat, atëherë ndeshjet e tij të zhvilluara deri në atë moment do të regjistrohen me rezultate të arritura, ndërsa

ndeshjet e mbetura deri në fund të kampionatit nuk do të zhvillohen dhe do të regjistrohen me rezultat zyrtarë (3:0) në favor të kundërshtarëve të tij të ardhshëm të paraparë me kalendar të garave.

Ndeshje e zhvilluar në kuptim të këtij neni, konsiderohet ndeshja e zhvilluar në fushë dhe e regjistruar me rezultat të arritur në fushë apo rezultat zyrtarë (në rast të ankesës së aprovuar).

Nëse garat zhvillohen sipas sistemit të njëfishtë të pikëve, konsiderohet se klubi e ka zhvilluar gjysmën e ndeshjeve, nëse është paraqitur në mbi 50% të ndeshjeve nga numri i tërësishëm i ndeshjeve të parapara me orarin e rregullt të garave:

- Nëse klubi i caktuar e fiton të drejtën për të hyrë në rang më të lartë të garave dhe nuk i plotëson kushtet e parapara me dispozita për atë rang të garave apo i njëjti klub tërhiqet me vetë dëshirë, atëherë vendin në rangun me të lartë të garave ia lëshon klubit tjetër.

Të drejtën për gara në rang më të lartë, të cilën nuk e shfrytëzon klubi që e zënë vendin e dytë e ka klubi që ka zënë një vend më poshtë se sa klubi që nuk e shfrytëzon këtë të drejtë:

- Nëse para fillimit të kampionatit një klub nuk licencohet apo tërhiqet nga garat KE do të vendos për plotësimin e vendit të lirë apo mos plotësim dhe për nivelin e garimit të klubit që është tërhequr nga garat apo që nuk është licencuar.
- Nëse gjatë zhvillimit të garave, për shkaqe të ndryshme tërhiqen apo largohen nga garat një apo më shumë ekipe të rangut të caktuar, atëherë ai rang i garave nuk do të plotësohet me ekipe të rangut me të ulët.

Fuzionimi i klubeve

Neni 62

Çdo klub merr vendim për fuzionim të klubeve në kuvendin e vet.

Fuzionimi kryhet para fillimit të kampionatit të ri, dhe atë më së voni 30 ditë para fillimit të kampionatit. Klubet e fuzionuara duhet të gjejnë një emër ndryshe nga ai që kanë pasur para fuzionimit.

Klubi i cili është rezultat i fuzionimit, pas fuzionimit mbanë të drejtat e ekipit më të mirë të plasuar (të klubeve të fuzionuara), si të ekipit të seniorëve, juniorëve, kadetëve, pionerëve, veç e veç për secilën garë në të cilën kanë garuar ekipet gjegjëse të klubeve të fuzionuara.

E drejta e paraqitjes dhe mënyra e regjistrimit të anëtarëve (deri në momentin fuzionimit) të klubeve të fuzionuara, përcaktohen me Rregulloren mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve.

Neni 63

Klubi i cili tërhiqet nga garat kampionale bien në rang më të ulët të garave, pa marrë parasysh rezultatet e arritura në gara deri në momentin e tërheqjes.

Konsiderohet se klubi (senior) është tërhequr nga garat, nëse me fajin e vetë nuk i ka zhvilluar dy ndeshje të asaj gare, gjatë një viti garues, ndërsa në kategoritë e reja kjo vlen pas tri ndeshjeve.

Ekipe të cilat tërhiqen nga garat e të cilat i takojnë kategorisë më të ulët të garave të FFK-së, nuk mund të regjistrohen sërish në të njëjtin rang të garave së paku 1 vjet. Ndaj klubit i cili tërhiqet nga garat, iniciohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullorës Disiplinore të FFK-së.

Fshirja e klubit nga garat

Neni 64

Klubi obligohet që detyrimet e veta, të cilat burojnë nga Propozicionet e garave dhe aktet tjera normative të FFK-së, t'i përmbushë në afatet të cilat përcaktohen me aktet normative.

Përfundimisht në rastet e arsyeshme, organi i cili udhëheq me gara, mund t'i shtyjë (prolongojë) afatet për përmbushjen e detyrimeve, mirëpo gjithsesi duke pasur kujdes që detyrimet e klubeve nga një sezon garues duhet të përmbushën me së voni 30 ditë para fillimit të garave në sezonin tjetër.

D.m.th. detyrimet nga stinori vjeshtor duhet të përmbushen më së voni 30 ditë para fillimit të stinorit pranveror, ndërsa detyrimet e stinorit pranveror më së voni 30 ditë para fillimit të vitit të ri garues.

Klubi i cili nuk vepron në pajtim me dispozitat e paragrafit së lartshënuar, me vendimin e organit kompetent garues do të fshihet nga garat e mëtejme, ndërsa nëse është fjala për detyrimet nga pjesa pranverore e kampionatit, nuk do t'i lejohet pjesëmarrja në garat e reja.

Neni 65

Ekipi i cili e fiton ndeshjen në garat kampionale arkëton 3 pikë, kurse nga ndeshja rezultati i të cilës është i barabartë, secili klub arkëton nga një pikë. Për secilën garë të përhershme e cila zhvillohet sipas sistemit të pikëve, përpilohet (mbahet) tabela.

Tabela përmban: emrat e ekipeve, numrin e ndeshjeve të zhvilluara, rezultatet e arritura në këto ndeshje, numrin e pikëve të fituara dhe numrin e golave të shënuara respektivisht të pranuar (pësuar);

- Plasmani i ekipeve në tabelë caktohet në bazë të pikëve të fituara,
- Plasman më të mirë siguron ekipi i cili ka fituar më shumë pikë,
- Nëse ekipet që kanë plasman të barabartë në tabelë, e garojnë për kreun e tabelës (titullin e kampionit), daljen në gara ndërkombëtare, largimin në rang më të ulët,

garojnë për barazh (mbetje, hyrje në ligë): do të merret për bazë rezultati dhe golaverazhi në takimet e ndërsjella,

- Nëse ekipet kanë plasman të barabartë edhe në takimet e ndërsjella atëherë mirën për bazë golat e shënuara në kampionat gjegjësisht cili ekip ka shënuar më shumë gola,
- Nëse ekipet i kanë edhe golat e shënuar gjate kampionatit të barabartë, atëherë merren për bazë golat e shënuar si mysafir gjate kampionatit,

Nëse në këtë mënyrë nuk mund të vërtetohet plasmani atëherë zhvillohen ndeshje në mes të ekipeve:

- Një ndeshje në fushën neutrale (nëse janë dy ekipe) që e cakton KE, e nëse pas 90 minuta, rezultati është i barabartë pasojnë shtyrja 2x15 minuta, e në rastë se rezultati mbetet i barabartë pasojnë penalltitë,
- Tri ndeshje me sistem të pikëve të njëfishta në terren neutral, nëse janë në kombinim 3 ekipe,
- Numër i nevojshëm i ndeshjeve në sistem të njëfishtë të pikëve, në terren neutral, nëse janë në kombinim 4 ose më tepër ekipe.

Nëse ekipet e theksuara në paragrafit paraparak arrijnë marrëveshje ndërmjet veti, në vend të zhvillimit të këtyre ndeshjeve, çështjen e fituesit mund ta përcaktojnë edhe me short, të cilin do ta udhëheq organi kompetent i garave.

Neni 66

Përfaqësimi i ekipeve në Garat Ndërkombëtare:

- Ekipi i cili shpallet kampion në garat kampionale përfaqëson Kosovën në garat e UEFA-së, (Liga e kampionëve),
- Ekipi nën kampion apo edhe më poshtë i klasifikuar mund të merr pjesë në garat e UEFA-së, nëse mundësohet kjo nga UEFA në bazë të koeficientit zyrtar për pjesëmarrje,
- Ekipi i cili shpallet fitues i Kupës së Kosovës, përfaqëson Kosovën në garat UEFA **Konferencë Ligë,**
- Nëse Ekipi fitues i KUPËS së Kosovës, për shkaqe të ndryshme nuk e përfaqëson Kosovën (nuk licencohet për garat e UEFA-së), atëherë zëvendësohet me ekipin e radhës që nuk është pjesëmarrës i garave të UEFA-së që ka plasmanin më të mirë respektiv në kampionatin e rregullt të Kosovës, e jo finalisti i KUPËS, me kusht që të jetë i licencuar paraprakisht për garat e UEFA-së.
- **Nëse ekipi i njëjtë shpallet kampion dhe fiton Kupën e Kosovës, në garat ndërkombëtare e përfaqëson ekipi i cili renditet në vendin e katërt në tabelë.**

Me vendimin e fundit të UEFA-së, Kosova do të përfaqësohet me 4 ekipe: ekipi kampion, ekipi nën kampion, vendi i tretë dhe fituesi i kupës apo ekipi përkatës.

Sistemi i KUPËS

Neni 67

Nëse ndeshja e zhvilluar me KUPËS-sistem të njëfishtë pas kalimit të kohës së rregullt përfundon me rezultat të barabartë do të zhvillohen vazhdimet. Nëse edhe pas kësaj rezultati është i barabartë atëherë zhvillohen vazhdimet 2 x 15 minuta.

Nëse edhe këtu ka rezultat të barabartë, atëherë fituesi do të përcaktohet pas ekzekutimit të penalltive.

Ekzekutimi i penalltive bëhet në mënyrë të paraparë me Bordin Ndërkombëtar - sipas udhëzimeve për ekzekutimin e penalltive për përcaktimin e fituesit në garat eliminuese. Sistemi Kupës përcaktohet me hollësisht me propozicione të veçanta.

Neni 68

Garat e KUPËS së Kosovës, zhvillohen në sistemin e tillë që së pari, me gara fillojnë ekipet e Ligës së tretë dhe Ligës së II-të, të cilat përmes eliminimit vijnë deri në 2 (dy) ekipet fituese të cilave më pastaj iu bashkëngjiten; 20 ekipeve të dy grupeve të Ligës së Parë dhe 10 ekipeve të SUPERLIGËS (gjithsej 32 ekipe) nga e 16-ta, e finales.

Të rregullohet zhvillimi i garave të Kupës nga e 16-ta, e finales (nikoqir vendas). Ndeshjet kanë sistem eliminimi – sistem i njëfishtë.

Ndeshjet e Kupës nga e 16-ta e finales kanë short gjysmë të dirigjuar.

Pjesëmarrëse 32 ekipe të ndara në dy vazo:

a) Në vazon e parë do të futen 16 ekipe dhe ato janë: **10 ekipet e Superligës, 3 ekipe të Ligës së Parë Grupi A të cilat janë të renditura nga vendi i parë, i dytë dhe i tretë, dhe 3 ekipe të Ligës së Parë Grupi B të cilat janë të renditura nga vendi i parë, i dytë dhe i tretë, në fund të edicionit vjeshtor (tabelën sipas rezultateve: vendi i parë, dytë, dhe tretë).**

b) Në vazon e dytë do të futen 16 ekipet tjera dhe atë: **14 ekipet e Ligës së Parë të Grupeve A dhe B, të cilat janë të renditura nga vendet 4 – 10 në tabelat e rezultateve të dy grupeve të treguara në fund të edicionit vjeshtor dhe 2 ekipet fituese të ardhura nga ndeshjet e rrathëve të zhvilluara nga ekipet e Ligës së Dytë dhe Tretë.**

c) Në ndeshjet e të 8-ës së finales së Kupës, në rastin e tërheqjes së shortit, cilësinë e ekipit nikoqir do ta kenë të gjitha ato ekipe fituese të cilat në rrethin e ndeshjeve nga e 16-ta, e finales së kupës ishin në cilësinë e ekipeve mysafire.

d) Nëse në short tërhiqen dy ekipe të cilat në rrethin e ndeshjeve të 16-ës **ishin mysafire**, atëherë ekipi i parë i tërhequr me short ka përparësi dhe llogaritet si nikoqir edhe e kundërta, nëse dy ekipet e tërhequra me short në ndeshjet e rrethit të kaluar **ishin nikoqire**, atëherë vlen rregulli i njëjtë sikurse në pasusin e më lartshënuar; ekipi i parë i tërhequr llogaritet si nikoqir.

e) I njëjti rregull dhe parim zbatohet edhe në rastin e tërheqjes së shortit për ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll.

f) Për ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës nuk vlen rregulli I shortit gjysmë të dirigjuar pasi që në këtë rreth zhvillohen nga dy ndeshje me sistem; vajtje ardhje.

g) Ndeshja finale luhet në kryeqytetin e Republikës së Kosovës në të cilën takohen fituesit nga ndeshjet gjysmëfinale.

Neni 69

Edhe në ndeshjen FINALE të KUPËS së futbollit të Kosovës apo atë të Super Kupës, nëse rezultati mbetet i barabartë, do të luhen vazhdimet (dy herë nga 15 minuta). Nëse edhe pas vazhdimëve rezultati është i barabartë, fituesi i KUPËS do të përcaktohet me ekzekutimin e penalltive. Ekzekutimi i penalltive do të bëhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren e IFAB dhe të UEFA-së.

Në ndeshjet e barazhit dhe finalen e KUPËS, shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjës i bartin klubet pjesëmarrëse 50% - 50%.

Regjistrimi i ndeshjës

Neni 70

Nëse pas ndeshjës nuk ushtrohet ankesa, e as nuk ekziston baza për regjistrimin e ndeshjës me rezultat zyrtar 3:0 (parforfe), ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur në terren.

Organi i cili udhëheq me gara i regjistron ndeshjet në afatin e paraparë me Propozicionet e garave gjegjëse, por nuk mund t'i regjistrojë ndeshjet para se të kalojë afati për ushtrimin e ankesës.

Ankesa ndaj ndeshjës së zhvilluar

Neni 71

Mbi rregullsinë e ndeshjës së garave të përhershme mund të vendoset në bazë të ankesës së klubit të dëmtuar ose sipas detyrës zyrtare të organit i cili udhëheq me gara.

Me klub të dëmtuar në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, nënkuptohet klubi i cili është i dëmtuar me rezultat të ndeshjës, ndaj të cilës ushtrohet ankesa.

Ankesa mbi të gjitha bazat duhet të paralajmërohet në Protokolin e ndeshjës, ose në mënyrë telegrafike në afat prej 24 orëve, nga përfundimi i ndeshjës ndërsa arsyetimi në dy kopje me dëshminë mbi taksën e paguar, duhet të dorëzohet me afat prej 48 orëve nga përfundimi i ndeshjës.

Nëse afati për ushtrimin e ankesës skadon në ditën e diele ose në ditën e festes shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës.

Paralajmërimi jo me kohë i ankesës, ushtrimi jo me kohë si dhe ankesa e pataksuar apo e taksuar jo në tersi do të hedhet poshtë. Dispozitat më të afërta mbi zhvillimin e procedurës në bazë të ankesës i parashohin Propozicionet e Garave.

Neni 72

Në situatë të jashtëzakonshme (gara e KUPËS, **ndeshjet e tri xhirove të fundit** etj.), me Propozicionet e Garave mund të parashihet procedure e posaçme në bazë të ankesës e kjo do të thotë, mund të parashihet që paralajmërimi, ushtrimi dhe vendosja mbi ankesën të bëhet në afate më të shkurtra.

Kur xhirot zhvillohen të dielën dhe të mërkurën atëherë kompletimi i lëndës së ankesës dhe taksimi i saj duhet të bëhet brenda 24 orëve nga përfundimi i ndeshjës së zhvilluar.

Nëse afati për ushtrimin e ankesës skadon në ditën e diele ose në ditën e festës shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës.

Organi që udhëheq me garat, është i obliguar që të shqyrtojë dhe vendos ankesën e paraqitur para fillimit të xhiros së radhës, qoftë kampionale apo e kupës.

Neni 73

Për çdo ankesë, duhet vendosur më së voni në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimi të saj.

Përrjashtim bëjnë rastet kur marrja e vendimit mbi ankesë varet nga ndonjë vendim tjetër, të cilin duhet ta merr një organ tjetër kompetent. Vendosja mbi ankesë do të shtyhet derisa të sigurohet vendimi përfundimtar i organit kompetent, por jo më larg se 15 ditë.

Nëse organi i shkallës së parë nuk vepron në kuptim të paragrafit të lartshënuar, konsiderohet sikurse ankesa të mos ishte aprovuar, andaj ushtruesi i ankesës ka të drejtë që t'i drejtohet shkallës së dytë pas kalimit të 15 ditëve nga dita e protokolimit të ankesës së shkallës së parë. Pas këtij afati pala ankuese ka 8 ditë kohë për ushtrimin e ankesës shkallës së dytë.

Neni 74

Për ankesat lidhur me garat e përhershme, në shkallë të parë vendosin organet të cilat udhëheqin me gara gjegjësisht Komisioni Organizativ i Garave. Mbi ankesat në vendimet e organeve nga paragrafi paraprak, vendosin organet e parapara me Propozicionet e garave, gjegjësisht Komisioni mbi ankesa (shkalla e II-të).

Afati i rregullt për ushtrimin e ankesave kundër vendimit të organit të shkallës së parë, është 8 (tetë) ditë nga dita e pranimi të vendimit.

Neni 75

Vendimi i shkallës së dytë duhet të mirëtohet më së largu në afat prej 8 ditëve nga dita e protokolimit të ankesës.

Nëse organi i shkallës së dytë nuk vepron në kuptim të paragrafi 1 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë që pas 15 ditëve nga dita e protokolimit të ankesës t'i drejtohet Komitetit Ekzekutiv (KE) për mbrojtjen e Rregullorës, duke konsideruar se nuk është aprovuar ankesa.

Komiteti Ekzekutiv duhet që të merr Vendim për çështjen më së largu 30 ditë nga ushtrimi i kërkesës për mbrojtje te Ligjshmërisë (**Komiteti Ekzekutiv mund të vendos në panel 3 ose 5 anëtarë**).

Ndaj vendimit të KE apo mos marrjes së Vendimit me kohë nga ana e KE-së, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet **organeve respektive të FIFA-së dhe UEFA-së**.

Neni 76

Pas fletëparaqitjes së drejtpërdrejtë apo indirekte të klubit të dëmtuar, pastaj fletëparaqitjes së vëzhguesit apo gjyqtarit të ndeshjes, organit apo organizatës së futbollit, si dhe sipas detyrës zyrtare, organi që udhëheqë me gara do të regjistrojë ndeshjen me rezultat zyrtar 3:0 (parforfe) në dëm të klubit i cili ka bërë njëerën prej kundërvajtjeve të cekura, respektivisht edhe me marrjen e një pike nga pikët e fituara, nëse ka kryer së paku dy nga këto kundërvajtje:

1. është paraqitur me lojtar i cili sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, nuk është i moshës përkatëse (adekuate) për të luajtur për ekipin gjegjës.
2. ka luajtur me lojtar për të cilin nuk është paguar anëtarësia për vitin garues rrjedhës vitin që është në vijim e sipër).
3. ka luajtur me lojtar i cili nuk i përmbush kushtet e parapara me këtë Rregullore lidhur me kontrollimin mjekësor.
4. ka luajtur me lojtar i cili brenda 48 orëve, ka luajtur edhe në një ndeshje tjetër dhe ajo nuk lejohet me këtë rregullore.

Nëse të dy klubet kanë bërë nga një kundërvajtje atëherë dy klubeve u mirëtohet nga një pikë, ndërsa ndeshja e zhvilluar nuk regjistrohet me rezultatin e arritur, por e njëjta duhet të përsëritet.

Nëse është në pyetje kundërvajtja në ndeshjen për kupë, atëherë ekipi i cili ka bërë kundërvajtjen eliminohet nga garat që d.m.th. ekipi kundërshtar kualifikohet për garat e mëtejshme.

Nëse në dy klubet në atë ndeshje kanë kryer nga një kundërvajtje të cekur më lartë, atëherë të dy klubet do të eliminohen nga garat e mëtutjeshme.

Nëse në ndeshjet për kupë, me ardhje-vajtje, ndeshja e parë, për çfarëdo arsyeje regjistrohet me rezultat zyrtar (3:0), takimi i kthimit nuk luhet fare. Nëse kjo ndodh në ndeshjen e dytë, atëherë ekipi i cili e humb me rezultat zyrtar (0:3), eliminohet nga garat e mëtutjeshme, pavarësisht nga rezultati i takimit të parë.

Neni 77

Në bazë të ankesës së ushtruar të klubit të dëmtuar, apo ndonjë pale tjetër me interes, do të mirëtohet vendim mbi regjistrimin e ndeshjës me rezultat 3:0 (parforfe) në favor të **ankuesit**, nëse nuk ka arritur rezultat më të mirë dhe atë po qe se klubi kundërshtar:

1. ka luajtur me lojtar i cili nuk është i regjistruar për këtë klub.
2. ka luajtur me lojtar i cili në atë ndeshje nuk ka pasur të drejtë loje.
3. ka luajtur me lojtar, identiteti i të cilit nuk është vërtetuar sipas dispozitave të kësaj Rregullore.
4. ka luajtur me lojtar për të cilin me vendim definitiv të shkallës së dytë të organit kompetent për regjistrimin e lojtarëve, është vërtetuar se është regjistruar me zbatimin jo të rregullt të dispozitave të akteve mbi regjistrimin, ose në bazë të të dhënave jo të sakta.

Marrja e vendimit nga paragrafi paraprak, nuk ka vend nëse regjistrimi i lojtarit është vërtetuar me vendim definitiv të shkallës së dytë të organit kompetent për regjistrim të lojtarëve. Pa marrë parasysh se është në zhvillim e sipër procedura sipas kërkesës për mbrojtjen e rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve.

Komisioni për vërtetimin e regjistrimit i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, është organ i shkallës së dytë, i cili vendos mbi ankesat lidhur me regjistrimin e lojtarëve të FFK-së:

5. Ka lojtar të evidentuar (shënuar) në protokolin zyrtar të ndeshjës (pa marrë parasysh se a është aktivizuar në lojë) përkundër që ai lojtar nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë rregullore dhe/ose nuk ka pasur të drejtë loje. **Rrjedhimisht, si masa ndëshkimore që do të merren në këtë rast janë:** do të merret vendim mbi regjistrimin e ndeshjës me rezultat 3:0 (parforfe) në disfavor të klubit dhe do të i hiqen në edicionin e atij viti garues edhe 3 (tre) pikë tjera shtesë klubit që e ka paraqitë – evidentuar (shënuar) në protokol lojtarin.
6. Ka luajtur me lojtarë të regjistruar mirë por i cili nuk i plotëson kushtet sipas Propozicioneve të garave gjegjëse.
7. Ka luajtur me lojtarë i cili gjendet nën dënim të ndalesës së lojës apo suspendim ose vetë ekipi është nën suspendim.
8. Ka luajtur me lojtarë i cili nuk është shënuar në Protokoll para fillimit të ndeshjës.

9. Ka zëvendësuar (ndërruar) më shumë lojtarë në atë ndeshje se sa që lejojnë dispozitat e kësaj Rregullore.

10. Ka luajtur me lojtarë i cili më parë është zëvendësuar (ndërruar) në atë ndeshje.

11. Ka luajtur me lojtarë i cili është i regjistruar përveç në atë klub edhe në ndonjë klub tjetër (pra ka dy regjistrime).

Organi i cili udhëheq me gara, përveç regjistrimit të ndeshjës me rezultat zyrtar, është i obliguar që edhe të iniciojë procedurën disiplinore para organit kompetent, kundër klubit dhe lojtarit.

Neni 78

Në bazë të ankesës së ushtruar të klubit të dëmtuar do të anulohet ndeshja dhe do të caktohet përsëritja e saj (ndeshja e re), në këto raste:

1. Nëse klubi kundërshtar ka luajtur me lojtar i cili sipas dispozitave të nenit 76 e kësaj Rregulloreje nuk ka pasur të drejtë loje, ndërsa organi që udhëheqë me gara ka vërtetuar, se për këtë rrethanë klubi nuk ka pasur kurrfarë faji, dhe se klubi nuk ka pasur dijeni e as që ka mundur të dijë për faktet të cilat e kontestojnë rregullsinë e regjistrimit dhe paraqitjen e lojtarit kontestues.
2. Nëse klubi kundërshtar ka luajtur me lojtarin ose ekipin i cili është i dënuar me ndalesë loje ose është i suspenduar me vendimin e organit kompetent disiplinor, e për këtë nuk është i informuar me shkrim ose me telegraf, ashtu siç e parashohin dispozitat e Rregullores Disiplinore, ose ka luajtur me lojtarë i cili është nën dënim apo suspendim e që e ka ndërruar klubin, ndërsa kjo masë disiplinore nuk i është shënuar në fletëregjistrim dhe në librezë të futbollit, e klubi për të cilin ka luajtur ky lojtar nuk është informuar në mënyrë të rregullte për këtë fakt.
- Për suspendim të menjëhershëm të shkaktuar më përjashtimin e lojtarit nga loja dhe dënim të menjëhershëm të shkaktuar për shkak të vërejtjeve publike të referit, nuk është e nevojshme të informohet me shkrim e as me telegraf klubi në ekipin e të cilit është kryer kundërvajtja, sepse përjashtimet dhe vërejtjet publike regjistrohen në protokoll të ndeshjës më të cilin gjithsesi disponon klubi.
3. Nëse vërtetohet se si njëri, ashtu edhe klubi tjetër kanë luajtur nën rrethana nga neni 76 i kësaj Rregullore.
4. Nëse klubi kundërshtar ka luajtur në ndeshjet e pionerëve, kadetëve apo juniorëve me lojtarë moshë e të cilit është më e vjetër, që të luaj në këto ekipe dhe nëse vërtetohet se klubi nuk e ka ditur e as që ka pasur mundësi të dijë për këtë fakt.
5. Nëse gjyqtari nuk ka zbatuar ose gabimisht e ka zbatuar ndonjërin prej dispozitave esenciale të Rregullave të lojës së futbollit dhe vendimet e Bordit Ndërkombëtar dhe Komitetit ekzekutiv të FFK-së, ndërsa kjo shkelje e dispozitës ka ndikuar në epilogun përfundimtar të ndeshjës. Këto dispozita i parashihet në mënyrë më të përafërte neni 88 i kësaj Rregullore. Nëse deri të anulimi i ndeshjës vjen për shkak të kundërvajtjes që parashohin pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, organi i cili udhëheq me gara është i obliguar

që organit kompetent disiplinor t'i ushtrojë përveç tjerave edhe fletëparaqitjen për atë lojtarë.

Në rast të anulimit të ndeshjës për shkak të kundërvajtjes nga pika 3 e këtij neni, përveç procedurës kundër lojtarit që parashihet me dispozitat e paragrafi paraprak, organi që udhëheq me gara duhet të inicojë edhe procedurën disiplinore kundër klubit sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore. Në rast të anulimit të ndeshjës për shkak të bazës të paraparë në pikën 5 të këtij neni, organi i cili udhëheq me gara është i obliguar që organit kompetent disiplinor t'i ushtrojë fletëparaqitje kundër referit.

Neni 79

Shkelja esenciale e Rregullave të lojës së futbollit dhe vendimeve të Bordit Ndërkombëtar dhe të Komitetit ekzekutiv të FFK-së (në tekstin e mëtutjeshëm RREGULLLAT E LOJËS), ekziston nëse gjyqtari nuk e ka zbatuar ose gabimisht e ka zbatuar ndonjë dispozitë, me çka ka ndikuar drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjës, po qe se ai vendim nuk trajtohet në sferën e bindjes së lirë të gjyqtarit.

Të gjitha vendimet që janë marrë në bazë të bindjes së lirë të gjyqtarit ("sipas mendimit të GJYQTARIT", "nëse gjyqtari mendon", "sipas bindjes së gjyqtarit"), nuk mund të futen nën kuptimin e shkeljes esenciale të dispozitave të Rregullave të lojës.

Shkelja esenciale e dispozitave të Rregullave të lojës ekziston:

1. Nëse ndeshja kampionale ose për kupë (në tekstin e mëtutjeshëm: ndeshjen) e drejton gjyqtari i cili nuk është i deleguar nga organi kompetent, respektivisht nuk është vepruar sipas dispozitave të nenit 23 të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Propozicioneve të garave gjegjëse.
2. Nëse ndeshja zhvillohet në terren, dimensionet e të cilit nuk janë në pajtim me dispozitat e nenit 31 dhe 32 të kësaj Rregulloreje, me atë që klubi i cili e ka ushtruar ankesën, për një gjë të tillë gjyqtarit i ka bërë kundërshtim me shkrim para fillimit të ndeshjës.
3. Nëse ndeshja është zhvilluar me më shumë se 11 lojtarë ose me më pak se 7 lojtarë.
4. Nëse pjesa e ndeshjës sipas orës së gjyqtarit ka zgjatur më shumë se 45 minuta, e që nuk ka qenë në pyetje kompensimi i kohës dhe për atë kohë të vazhduar është shënuar gol i cili ka ndikuar drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjës.
5. Nëse nga gjuajtja e lirë indirekte është shënuar gol, të cilin referi e ka pranuar e që ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjës.

6. Nëse gjatë hedhjes së topit me dorë në lojë (nga auti), lojtari e ka hedhur atë në portë (rrjetë) pa e prekur askush tjetër, kurse gjyqtari e ka pranuar këtë gol, i cili ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes.

7. Nëse me rastin e lëshimit të topit nga dora e gjyqtarit ("topi i gjyqtarit"), topi ka hyrë në portë (në rrjetë), kurse gjyqtari e ka pranuar këtë gol i cili ka ndikuar drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes.

Neni 80

Nëse ankesa ka të bëjë vetëm me parregullsitë e shkaktuara gjatë ekzekutimit të penalltive, me të cilat përcaktohej fituesi i ndeshjes pas zhvillimit të ndeshjes respektivisht edhe të vazhdimeve dy herë nga 15 minuta, atëherë organi kompetent nëse vërteton parregullsinë mund të marrë vendim vetëm për ekzekutimin e serishëm të penalltive, e jo edhe për përsëritjen e ndeshjes, po që se loja e rregullt respektivisht vazhdimet dy herë nga 15 minuta janë zhvilluar sipas Rregullave të lojës.

Nëse me rastin e shqyrtimit të ankesës vërtetohet, se gjyqtari gjatë zhvillimit të vazhdimeve të ndeshjes dy herë nga 15 minuta, ka bërë shkelje esenciale të Rregullave të lojës, e cila shkelje ka ndikuar drejtpërdrejt në epilogun përfundimtar të ndeshjes, ndeshja do të përsëritet dhe do të caktohet termini i ri për zhvillimin e saj.

Anulimi i ndeshjes sipas detyrës zyrtare

Neni 81

Ndeshja do të anulohet sipas detyrës zyrtare ndeshja do të caktohet zhvillimi i saj i serishëm, po që se vërtetohet se gjyqtari i shtyrë nga motivet amorale ka ndikuar në epilogun përfundimtar të ndeshjes, e cila ju ka besuar ta gjykojë.

Deri te anulimi i ndeshjes mund të vjen në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës kompetente për vepër penale dhënia dhe marrja e mitos ose vendimit të plotfuqishëm të organit kompetent disiplinor për këtë vepër ose për vepër tjetër amorale të paraparë me aktet e përgjithshme normative e FFK-së.

Anulimi sipas kësaj baze mund të bëhet deri në përfundim të periudhës garuese.

Inicimi i procedurës sipas fletëparaqitjes apo detyrës zyrtare nga ana e organit kompetent garues, ka vend vetëm në kusht që vendimi i plotfuqishëm nga paragrafi paraprak është bërë i plotfuqishëm deri në fund të periudhës garuese.

Me përfundim të periudhës garuese në kuptim të këtij neni, nënkuptohet dita kur organi kompetent garues e ka vërtetuar tabelën përfundimtare të garave gjegjëse.

Anulimin e ndeshjës mund ta bëjë organi që udhëheq me garat dhe nëse konstatohet se klubet kanë kurdisur rezultatin dhe organet gjegjëse hetimore dhe gjyqësore kanë vërtetuar një gjë të tillë.

Kurdisje konsiderohet edhe dhënia e mitos lojtarëve, trajnerëve dhe zyrtarëve të klubeve për arritjen e rezultatit të dëshiruar me anë të mitos.

Nëse nga ana e organit kompetent vërtetohet se të dy klubet kanë marrë pjesë në kurdisjen e rezultatit, e njëjta do të regjistrohet si ndeshje e luajtur, rezultati i saj nuk do të regjistrohet gjegjësisht pikët dhe golat e shënuara nuk do të regjistrohen në tabelën e klasifikimit por që ndaj klubeve do të iniciohet procedura disiplinore dhe do të dënohen sipas Rregullores Disiplinore të FFK-së.

Nëse nga personat e tretë apo klubi i tretë bëhet kurdisja e rezultatit të ndeshjës në të cilën merr pjesë vetëm njëri klub-pjesëmarrës në ndeshje, rezultati i asaj ndeshjeje do të anulohet, do të caktohet ndeshja e radhë klubi fajtor do të dënohet sipas dispozitave disiplinore të FFK-së.

Dhënia e premive për fitore nuk konsiderohet mito.

Ndaj të gjithë atyre që janë të involvuar në kurdisje të rezultateve do të iniciohet procedura disiplinore.

Respektimi i sponsorit

Neni 82

FFK është pronare e të drejtave televizive dhe të tjera të lidhura me to.

Federata e Futbollit e Kosovës ka të drejtë të kërkojë sponsorë për çdo ligë veç e veç. Në bazë të detyrimeve të dyanshme mes sponsorit të ligës përkatëse dhe FFK-së, klubet e rangut përkatës kanë obligim respektimin e lëndës së marrëveshjes, e cila i lehtëson klubet.

Klubi i cili nuk i respekton obligimet e përcaktuara mes sponsorit të ligës dhe FFK-së, do të dënohet në bazë të Rregullores Disiplinore.

IV. DISPOZITAT E POSAÇME

Mbrojtja e Rregullores

Neni 83

Ne baze të nenit 84 të kësaj Rregullore, pos klubit të dëmtuar, komisioni për akte normative i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, (me vete iniciativë apo me propozimin e subjekteve të interesuara) kur vlerëson se janë shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje, mund të ushtrojë Kërkesën për mbrojtjen e Rregullores mbi garat e futbollit.

Komisioni për akte normative i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, e ushtron kërkesën për mbrojtjen e kësaj Rregulloreje në rastet kur janë në pyetje vendimet që i kanë marrë organet e Komitetit Ekzekutiv, respektivisht organet tjera, e që kanë të bëjnë me klubet e të gjitha rangjeve të garave të Kosovës, si dhe kur është fjala për vendimet e pa harmonizuara të dy apo më shumë organeve ekzekutive të tij.

Kërkesa për mbrojtjen e Rregullores së garave të futbollit, mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Kërkesa i ushtrohet me shkrim Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, përmes organit i cili ka marrë vendimin definitiv. Nga Kërkesa për mbrojtjen e Rregullores nuk mund të hiqet dorë, nëse sipas propozimit të organit kompetent ka filluar procedura e paraparë me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 84

Për kërkesën mbi mbrojtjen e Rregullores së garave të futbollit vendos Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Nëse organi kompetent nga paragrafi paraprak e vërteton se kërkesa për mbrojtjen e rregullores mbi garat e futbollit është e bazuar, atëherë do të marr vendim mbi prishjen e vendimit të atakuar përfundimtar, duke ia kthyer lëndën organit kompetentë (Komisionit për ankesa të shkallës së II-të), që sërish të vendosë për atë lëndë. Nëse Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, e sheh të arsyeshme, atëherë do të vendos vetë për atë lëndë. Vendimi i Komitetit Ekzekutiv nga linja paraprake, nuk mund të atakohet me asnjë mjet juridik.

Neni 85

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, pas shqyrtimit të Kërkesës për mbrojtjen e Rregullores, mund të vendos që ta prish vendimin duke ia kthyer lëndën në shqyrtim të serishëm organit kompetent, i cili është i obliguar që të ndërmarrë veprimet konkrete për t'i shqyrtuar të gjitha ato çështje për të cilat i ka sugjeruar Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

Nëse rastet kur organi të cilit i është kthyer lënda në shqyrtim, nuk vepron sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, atëherë ky organ (Komiteti Ekzekutiv) për këtë lëndë do të vendos sipas detyrës zyrtare.

Neni 86

Nëse Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, e vërteton në çfarëdo mënyrë, se organet kompetente për zbatimin e kësaj Rregulloreje, nuk i kanë përfillur dispozitat e kësaj Rregulloreje si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural gjatë vendosjes mbi çështjet e caktuara në garat e futbollit, atëherë Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë që sipas detyrës zyrtare të marrë vendimin definitiv mbi atë çështje, kurse ndaj anëtarëve

të organeve të tilla të iniciojë procedurën disiplinore dhe të kërkojë apo të shqiptojë masat konkrete të parapara me aktet normative të FFK-së.

Vendimi i Komiteti Ekzekutiv nga paragrafi paraprak nuk mund të atakohet me asnjë mjet të rregullt juridik të FFK-së. **Ndaj Vendimit të Komitetit Ekzekutiv (ose mos marrjes të ndonjë vendimi me kohë), pala e pakënaqur mund të drejtohet Arbitrazhit Sportiv, të FFK-së, si dhe në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Llozanë CAS.**

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 87

Vendimet obligative për zbatimin e Rregullave të lojës së futbollit të marra nga ana e organeve kompetente ekzekutive të FFK-së, para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të zbatohen edhe më tutje gjithnjë, derisa çështja që rregullohet me këto vendime mos të rregullohet me akte të përgjithshme normative të FFK-së.

Neni 88

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së është i autorizuar që të jep udhëzime për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe të bëjë interpretimin e dispozitave të saj.

Neni 89

Rregullorja është aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, datë 25 Prill 2006, dhe pas plotësimeve dhe ndryshimeve në bazë të nenit 2 pika c, të statutit të ri të FFK-së, të aprovuar me 27 Janar 2023, Komiteti Ekzekutiv në mbledhjen e vet të mbajtur datën 04 Korrik 2023, aprovoi këtë Rregullore e Garave.

Rregullorja hyn në fuqi një ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 04 Korrik 2023

Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së,

Agim Ademi